



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Raport Vjetor i Punës

Për vitin 2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2015

***PRISHTINË
Mars, 2016***



Tabela e Përmbajtjes

1	Përmbledhje Ekzekutive	5
2	Korniza Ligjore.....	6
2.1	Aktet Nënligjore të Agjencisë	6
2.2	Përmirësimi i Bazës Ligjore në Periudhën Raportuese.....	7
3	Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional)	8
3.1	Përgjegjësitë.....	8
3.2	Autorizimet	8
3.3	Misioni	9
3.4	Vizioni	9
3.5	Objektivat	9
4	Fushëveprimi i Agjencisë	10
4.1	Organizimi i Agjencisë	10
4.2	Këshilli	10
4.2.1	Mandati	10
4.2.2	Kompetencat	11
4.2.3	Funksionalizimi.....	11
4.3	Burimet Njerëzore	13
4.3.1	Nevojat për Punonjës të Rinj	13
4.3.2	Paraqitja në Formë Tabelare e Numrit dhe Llojit të Trajnimeve, Punëtorive dhe Tryezave.....	14
4.3.3	Plani i Trajnimit për Personelin e Angazhuar në Kuadër të ASHMDHP-së për Vitin 2015	16
4.3.4	Asetet	17
5	Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale	18
5.1	Këshilla dhe Opinione	18
5.2	Këshillat e Drejtpërdrejta nga Mbikqyrësit	20
5.3	Konsultim me Rastin e Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative	20
5.4	Ankesat	23
5.5	Inspektimi dhe Kontrolli	24
5.5.1	Inspektimet	24
5.5.2	Kontrollet	30



5.5.3	Përpunimi i të Dhënave Biometrike	31
5.5.4	Transferimi i të Dhënave Personale	31
5.6	Informimi dhe Promovimi	32
5.7	Bashkëpunimi Vendor dhe Ndërkombëtar	36
5.8	Bashkëpunimi me Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave	39
5.9	Regjistrimi i Sistemit të Dosjeve	41
5.10	Vëzhgimi me Kamerë	42
5.11	Projekti IPA	43
5.12	Raporti i Progresit 2015 për Kosovën nga Komisioni Evropian.....	43
6	Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	44
7	Raporti Financiar	47
7.1	Përmbledhje të Zhvillimeve Kryesore përBuxhetin.....	47
7.2	Përmbledhje për të Hyrat dhe Kategoritë e Veçanta të Shpenzimeve.....	48
7.3	Përmbledhje e Vërejtjeve Përfundimtare dhe Pikëpamjet për Zhvillimet e Ardhshme	49
7.3.1	ObjektivateVazhdueshme2014-2016	50
7.4	Tabelat 5- Detajet e Shpenzimeve. Sipas Kodeve Ekonomike	50
7.4.1	Tëhyrat.....	50
7.4.2	Shpenzimet e Përgjithshme	51
7.4.3	MallradheShërbime	52
7.4.4	Shpenzimet Komunale	58
7.4.5	Investimet Kapitale	59
7.4.6	Subvencione dhe Transfere	62
7.4.7	Personeli dheStrukturaePagave.....	63
8	Raportimi rreth Adresimit të Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm	64

1 Përmbledhje Ekzekutive

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e paraqet para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe opinionit në nivel vendi, raportin e punës së saj të aktiviteteve të përgjithshme gjatë vitit 2015. Me këtë raport, Agjencia paraqet pasqyrën e përgjithshme të zhvillimeve dhe aktiviteteve të saj në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe para deputetëve të Kuvendit dhe grupeve punuese të tij (Kuvendit), nxjerr vlerësimet e veta, si dhe për të ardhmen (në vazhdim) i jep rekomandimet e nevojshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në raport do të gjeni përshkrimin e shkurtë të akteve ligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e Agjencisë dhe njëkohësisht japin bazamentin orientues lidhur me parimet e përpunimit të të dhënave personale. Kjo kornizë ligjore, gjithashtu përshkruan organizimin, fushëveprimin, përgjegjësitë, autorizimet dhe detyrimet ligjore ndaj subjekteve të të dhënave personale. Përshkrimi i aktiviteteve në raportin e punës është bërë në përputhje me planin e punës (2015) dhe objektivat e Strategjisë (2014-2017); duke përfshirë këtu: inspektimet, kontrollet, trajtimin e ankesave, vendimmarrjet e Këshillit të Agjencisë, sensibilizimin, ngritjen profesionale (trajnimet), promovimin, bashkëpunimin ndërinstitucional, dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Sipas kërkesës standarde të raportimit, raporti, në fund, jep edhe pasqyrën e vlerësimeve të auditorit gjeneral për ASHMDHP-në dhe pasqyrat financiare të këtij institucioni për vitin 2015.

Siç është konfirmuar edhe nga Raporti i Progresit për Kosovën (2015), Agjencia tashmë ka shënuar përparime të dukshme në fuqizimin e kapaciteteve të saj, si: në inspektime, në sensibilizim, në dhënien e këshillave për kontrolluesit publik dhe privat, në dhënien e opinionëve, etj. Ndërkaq gjatë 2015 është shënuar rritja e numrit të ankesave dhe pyetjeve të shumta të adresuara Agjencisë. Ndërsa nën prizmin e fokusimeve të jashtme të shoqërisë civile dhe medimeve, në respektim të kërkesave për qasje në dokumente publike, edhe pse Agjencia nuk kishte mandat për zbatimin e ligjit që rregullon këtë fushë, në balancimin e dy të drejtave (mbrojtja e të dhënave personale dhe qasja në dokumentat publike), ajo, me përkushtim ka dhënë këshilla, opinione dhe ka nxjerrë vendime në balancimin e qasjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke dhënë kontribut të veçantë në këtë drejtim.

Promovimi dhe ndërgjegjësimi ishin, gjithashtu, fokus i Agjencisë, për të cilat, raporti, në mënyrë analitike, sjell të dhëna faktike. Emërimet e të gjithë zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale në nivel vendi tashmë është punë e kryer për Agjencinë.

Agjencia ka nxjerrë broshura për nivelin lokal dhe atë qendror. Kështu mund të përmendim:

- *Doracakun mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Zyrtarët Komunalë;*
- *Udhëzuesin mbi Kriteret e Vëzhgimit me Kamerë në Institucionet Arsimore;*
- *Planin e Përgjithshëm mbi Trajnimin e Zyrtarëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
- *Udhëzuesin për Planprogramin e Trajnimit në Teknologji Informative për Mësimdhënësit e TI-së mbi Çështjet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale për Adoleshentët;*

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Agjencia ka marrë konfirmimin e anëtarësimit të plotë në mekanizmin e autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale të Evropës Juglindore, gjatë punimeve të takimit të mbajtur në Durrës të Shqipërisë. Ka marrë pjesë në punëtorinë në Tiranë në "Case Handling Workshop (CHW)". Ka marrë pjesë e konferencën pranverore të autoriteteve të BE-së "Spring Conference" në Mançester të Anglisë, pastaj është pranuar si kandidat për anëtarësim të përhershëm në autoritetet frankofone të mbrojtjes së të dhënave personale. Agjencia, që nga janari i vitit 2014 mbështetet nga projekti IPA (projekt i financuar nga BE), i cili përfundon në janar të vitit 2015, dhe nga Zyra e BE-së është konfirmuar mbështetja dhe vazhdimi i IPA-I, deri në shtator të vitit 2016 në sajë të asistencës teknike për Agjencinë.

2 Korniza Ligjore

Në Republikën e Kosovës, e drejta për mbrojtjen e dhënave personale dhe privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo e drejtë, e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfshinë respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç janë:

- 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj;

Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejt të aplikueshme edhe në vendin tonë. Konventat dhe direktivat evropiane, të cilat rregullojnë fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë janë: Konventa 108/EC dhe protokollat shtesë (për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale); Direktiva 95/46/EC; Direktiva 2002/58/EC (e-privatësia dhe komunikimet elektronike).

Në vitin 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172) i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themeloi institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.

Legjislacioni primar dhe sekondar i cili rregullon përpunimin e të dhënave personale duhet të jetë në harmoni me parimet të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2.1 Aktet Nënligjore të Agjencisë

Në harmoni me nenin 94 të Ligjit Nr. 03 /L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të zbatimit të ligjit, Agjencia ka nxjerrë akte nënligjore dhe dokumente përcjellëse administrative.

Aktet Nënligjore

1. Rregullorja e Punës së Agjencisë Nr. 20/2011;
2. Rregullorja Nr. 01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit;
3. Rregullorja Nr. 03/2012 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;
4. Rregullorja Nr. 01/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës;
5. Rregullorja nr. 01/2015 për Mënyrën e Ruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialit Arkivor dhe të Protokollit;
6. Rregullorja Nr. 02/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2012 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;
7. Rregullorja Nr. 03/2015 mbi Masat e Sigurisë gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;

8. Rregullorja Nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave;
9. Rregullorja Nr. 05/2015 për Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit të Sistemit të Dosjeve të të Dhënave Personale dhe Formularit të Regjistrit Përkates;
10. Rregullorja Nr. 06/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2015
11. mbi Masat e Sigurisë gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;
12. Udhëzimi Administrativ për Kartelat Zyrtare të Mbikëqyrësve Shtetërorë 03/2012; (i miratuar nga Qeveria me propozim të Agjencisë, konform nenit 47 të Ligjit nr. 03/L-172);
13. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014 për Avanse, Reprezentacion, Telefoni Fikse dhe Mobile;
14. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Pyetjeve të Ardhura në Agjenci dhe Aplikimet për Dokumente Publike;
15. Kodi i Etikës për Punonjësit e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Dokumente Strategjike

- Strategjia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Periudhën 2014-2017.

Dokumente Përcjellëse Administrative

- Formulari i Ankesës.
- Formulari i Procesverbalit të Inspektimit dhe Kontrollit.
- Formulari për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave.
- Lista e Kontrollit
- Formulari i Kërkesës për Regjistrim të Kontrollorëve.
- Lista e Kontrollit "Pajtueshmëria e Akteve Ligjore dhe Nënligjore me Ligjin Nr. 03 / L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2.2 Përmirësimi i Bazës Ligjore në Periudhën Raportuese

Agjencia ka përmirësuar bazën ligjore për zbatimin e ligjit, duke nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e plotë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjatë vitit 2015, Agjencia i ka kushtuar rëndësi të veçantë avancimit të kuadrit ligjor ekzistues, duke nxjerrë akte nënligjore që kanë pasur për qëllim zbatimin sa më të gjerë të ligjit. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Agjencia ka nxjerrë këto akte nënligjore:

- Rregulloren nr. 01/2015 për Mënyrën e Ruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialit Arkivor dhe të Protokollit;
- Rregulloren Nr. 02/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2012 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;
- Rregulloren Nr. 03/2015 mbi Masat e Sigurisë gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;
- Rregulloren Nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave;
- Rregulloren Nr. 05/2015 për Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit të Sistemit të Dosjeve të të Dhënave Personale dhe Formularit të Regjistrit Përkates;
- Rregullorja Nr. 06/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2015
- mbi Masat e Sigurisë gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;

3 Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional)

3.1 Përgjegjësitë

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Agjencia kryesohet nga këshilli, i cili përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore, ushtruesit e pushtetit publik si dhe institucionet private për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale. Agjencia duhet të konsultohet nga Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, me rastin e hartimit të masave legislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia vendosë lidhur me ankesat e personave nëse ai ose ajo konsideron se e drejta e tij/saj për mbrojtjen e të dhënave është shkelur, si dhe informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe masat e ndërmarra; Jep pëlqimin lidhur me krijimin e sistemit të dosjeve si dhe krijon dhe mirëmbanë regjistrin e sistemit të dosjeve; Mbikëqyrë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për sigurimin e të dhënave personale; Kryen inspektime dhe kontrole për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të cilit do ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale; Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave; Parashtron kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave, siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Përpilon planin vjetor të punës si dhe paraqet para Kuvendit raportin vjetor të punës në lidhje me zhvillimet, vlerësimet dhe rekomandimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe të njëjtin e bën publik; Ia propozon Kuvendit buxhetin për nevojat vjetore të Agjencisë; Nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit, etj.

3.2 Autorizimet

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, Agjencia kryen inspektime dhe kontrole. Inspektimet dhe kontrollet kryhen drejtpërdrejt nga mbikëqyrësit shtetërorë. Mbikëqyrësit kryejnë inspektime dhe kontrole të rregullta, në bazë të detyrës zyrtare si dhe sipas ankesës. Në këtë kuadër, mbikëqyrësit shtetërorë kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga

besueshmëria ose fshehtësia e tij; Kontrollonjë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogjet e sistemeve të dosjeve; Kontrollonjë çdo dokumentacion dhe udhëzim që rregullon sigurinë e të dhënave personale; Kontrollonjë ndërtesën në të cilën përpunohen të dhënat personale dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe të konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik; Verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim sigurimin e të dhënave personale dhe zbatimin e tyre; Kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë ligj.

3.3 Misioni

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke pasur status të pavarur, ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Këshillimi i organeve publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollet, informimi i publikut, si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e fushëveprimtarisë kryesore në kuadër të misionit të Agjencisë.

3.4 Vizioni

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, sipas strategjisë së aprovuar, Agjencia synon të realizojë këto objektiva: Harmonizimin e plotë të kornizës ligjore me *Acquis Communautaire* të BE-së; Ndërgjegjësimin e qytetarëve për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave përmes inspektimeve dhe kontrolleve; Thellimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve me organet dhe institucionet tjera, si dhe me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; Ngritjen profesionale të personelit të Agjencisë, funksionalizimin e plotë të strukturës organizative, si dhe sigurimin e hapësirave shtesë të punës; Fushatën njoftuese dhe ndërgjegjëse për opinionin publik përmes aktiviteteve përkatëse; Mbajtjen e takimeve, konferencave; Bashkëpunimin rajonal dhe nënshkrimin marrëveshjeve me karakter rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale; Regjistrimin e të gjitha sistemeve të dosjeve të institucioneve publike dhe private.

3.5 Objektivat

Mbikëqyrja e vazhdueshme e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave synohet të arrihet duke zhvilluar aktivitete në dy fusha:

- Edukimin e organeve publiko-private;
- Ngritjen e vetëdijes së qytetarëve;
- Harmonizimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* të BE-së;
- Zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit përmes inspektimeve dhe kontrolleve;
- Trajtimin e ankesave;
- Ngritjen e kapaciteteve.

4 Fushëveprimi i Agjencisë

4.1 Organizimi i Agjencisë




Figura 1 – Organogrami i Agjencisë

Agjencia përbëhet nga Këshilli, zyra Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror, Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Departamenteve.

Struktura organizative është si më poshtë:

- Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror
- Mbikëqyrësit Shtetërorë
- Drejtori i Përgjithshëm
- Departamentet
- Zyra për Mbështetje të Inspektimit
- Këshilltari Ligjor i Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror
- Personeli mbështetës (stafi i mirëbesimit).

4.2 Këshilli

4.2.1 Mandati

Këshilli i Agjencisë përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar, me mundësi të emërimit edhe për një mandat tjetër. Këshilli përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë. Këshilli i Agjencisë është emëruar më 23.06.2011 dhe mandati i tij përfundon më datën 23.06.2016.

4.2.2 Kompetencat

- Këshilli jep këshilla për institucionet publike dhe private për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse;
- Këshilli vendosë për parashtrimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera, kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave si që parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- Këshilli vendosë për parashtrimin e padive në gjykatën kompetente kur konsideron se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur;
- Këshilli vendosë lidhur me ankesat e parashtruara;
- Këshilli vendosë bashkëpunimin me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Këshilli aprovon strategjinë dhe planin vjetor të punës;
- Këshilli aprovon raportin vjetor të punës;
- Këshilli vendosë për publikimin e gazetës së Agjencisë dhe literaturës profesionale;
- Këshilli nxjerr akte nënligjore, autorizime dhe vendime;
- Këshilli aprovon propozim buxhetin e Agjencisë;
- Këshilli vendosë për transferimin e të dhënave personale.

4.2.3 Funksionalizimi

Këshilli i Agjencisë është funksional dhe në përbërje të plotë pesë anëtarëshe. Gjatë vitit 2015:

- Janë mbajtur 25 mbledhje të Këshillit të Agjencisë,
- Janë nxjerrë 73 vendime,
- 2 vendime për dhënien e autorizimit për transferim ndërkombëtar të të dhënave,
- 1 koment për koncept dokument,
- Janë dhënë 8 opinione,
- Janë hartuar 25 procesverbale.

4.2.3.1 Ekzekutivi

Drjetori i Përgjithshëm i Agjencisë - Organizimi dhe përcjellja e funksionimit të mirë të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm; Bashkëpunimi me departamentet dhe zyrat, sipas udhëzimeve të drejtorit të përgjithshëm, lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të punës brenda afateve kohore; Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për implementimin e një strukture të kontrollit të brendshëm financiar në organizatën buxhetore; Drejtori i Përgjithshëm ka për detyrë përmirësimin e standardeve në të gjitha shërbimet e ofruara nga institucioni; Përgatitja e analizave të nevojshme për nevojat buxhetore dhe mbeshtetja efikase administrative; Marrja e vendimeve sipas legjislacionit përkatës për mbarëvajtjen e punës së institucionit.

Departamentet - departamentet janë njësi organizative të Agjencisë, udhëhiqen nga drejtorët, të cilët, për punën e tyre i raportojnë mbikëqyrësit kryesor shtetëror, kurse për çështje administrative Drejtorit të Përgjithshëm; Drejtori i departamentit është nëpunës civil i nivelit drejtues i cili menaxhon punën në departamentin e tij; Në bazë të kërkesave dhe nevojave të punës, departamentet përbëhen nga divizionet.

Në kuadër të Agjencisë ekzistojnë tri (3) departamente dhe një (1) zyrë:

- Departamenti për Regjistrim dhe Marrëdhënie me Jashtë;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Administratës;
- Zyra për Mbështetje të Inspektimit.

Departamenti për Regjistrim dhe Marrëdhënie me Jashtë (DRMJ) - Ushtron funksione dhe detyra ligjore, realizon një komunikim bashkëpunues me të gjitha departamentet e Agjencisë dhe me të gjithë zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të organeve publike, si dhe subjektet kontrolluese të të dhënave, duke administruar me efektivitet informacionin mbi kontrollin dhe përpunimin e të dhënave personave, me qëllim garantimin e ushtrimit të kompetencave ligjore. Ky departament përbëhet prej dy (2) divizioneve:

1. Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrimit;
2. Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë dhe me Publikun.

Departamenti Ligjor (DL) - Departamenti Ligjor është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjive legislative në bashkëpunim të ngushtë me mbikëqyrësin kryesor shtetëror, me departamentet dhe me njësitë e tjera organizative të Agjencisë, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar. DL përbëhet prej dy (2) divizioneve:

1. Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit (D.H.H.L);
2. Divizioni për Përfaqësim Gjyqësor (D.P.GJ).

Departamenti i Administratës - Departamenti është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen e pasurisë së përgjithshme të Agjencisë, organizimin e hapësirave të punës, planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave, mbështetjen administrative dhe logjistike, ofrimin e shërbimeve të përkthimit, arkivimin si dhe shpërndarjen e materialit. Departamenti përbëhet prej dy (2) divizioneve:

1. Divizioni i Shërbimeve Financiare;
2. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme.

Zyra për Mbështetje të Inspektimit - Mbështetet drejtpërdrejt mbikëqyrësin kryesor shtetëror dhe mbikëqyrësit shtetërorë tjerë në kryerjen e detyrave të inspektimit dhe kontrolleve të të gjithë kontrolluesve publikë dhe privatë. Përgatitë këshilla në fushën e inspektimit dhe kontrollit për mbikëqyrësin kryesor shtetëror dhe mbikëqyrësit shtetërorë lidhur me legjislacionin në fuqi. Harton dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve nënligjore dhe akteve administrative pas kryerjes së inspektimit dhe kontrolleve.

Këshilltari Ligjor i Mbikqyrësit Kryesor Shtetëror - Këshilltari ligjor i mbikqyrësit kryesor shtetëror është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë dhe këshilla ligjore mbikqyrësit kryesor shtetëror për çështje që kërkojnë nga ai lidhur me çështje ligjore dhe administrative.

Personeli Mbështetës - Agjencia mund të rekrutojë personel përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe administrative (asistenti administrativ dhe shoferi i MKSH-së). Personeli mbështetës (stafi i mirëbesimit) nuk janë nëpunës të rregullt të Agjencisë.

4.3 Burimet Njerëzore

Tabela 1 – Burimet Njerëzore

	Nr i punëtorëve në	Nr aktual i punëtorëve		Nr aktual i punëtorëve në	
ASHMDHP	Ligjin e Buxhetit	në fillim të 2015		fund të vitit 2015	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Funksionar Publik të Emëruar	5	5		5	
Administrata Qendrore	18	18		18	
Total	23	23		23	

4.3.1 Nevojat për Punonjës të Rinj

Që nga koha e themelimit, në qershor 2011, Agjencia ka funksionuar me një buxhet të kufizuar, numër të vogël të lejuar të personelit dhe për këtë arsye nuk janë funksionalizuar plotësisht ose nuk janë formësuar departamentet e parapara me strukturë organizative.

Si shkak i numrit të vogël të personelit, zyrtarët janë të angazhuar deri në pesë funksione, duke arritur edhe certifikimin në pjesën e shpenzimeve ku vlenë të ceket se në vitin 2015 janë ertifikuar të gjithë zyrtarët që i parasheh Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësi nga Manuelli i Thesarit, si dhe është certifikuar edhe zyrtari i prokurimit.

Agjencia, gjatë vitit 2015, në pamundësi që ti kryej me kapacitete të brendshme procedurat e prokurimit, këtë segment e ka realizuar përmes personelit të prokurimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes dy (2) institucioneve. Gjithashtu edhe auditimin e brendshëm e kemi realizuar nga Zyrtari i Auditimiti MPJ-së, bazuar në marrëveshjen e lartëcekur.

Bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror, dhe të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, janë paraparë të jenë 37 zyrtarë, kurse për vitin 2015 i kemi të miratuar vetëm 18 zyrtarë (shërbyes civilë).

Për funksionalizim po thuajse të plotë dhe për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative, fushëveprimi i të cilave është i përcaktuar në përputhje të obligimeve që dalin nga Ligji 03/L-172, Rregullores së Punës së Agjencisë dhe legjislacionit në fuqi, në mbështetje të punës së këshillit të Agjencisë- ne kemi planifikuar nevojat e domosdoshme edhe për **9 pozita pune**, ku numri i përgjithshëm i personelit do të mbërrijë në 27 zyrtarë, duke parashikuar edhe nevojën për personel të mandatuar në zyrat e funksionarëve publikë, gjegjësisht personeli mbështetës (stafi i mirëbesimit) dhe këshilltari ligjor i MKSH-së.

Kostoja totale vjetore do të jetë: €4.468,14 * 12 muaj gjatë vitit 2016: 53.617,68 euro

Tabela: 2-Personeli i nevojshëm në ASHMDHP

Nr.	Titulli i Pozitës	Koeficient i	Paga Bazë	Shtesat Mujore	5% i Kontributeve	Totali i Pagave
1	Drejtor i Dep.për financa dhe shërb. të përgjithëshme	10	582,73	30	30,64	643,36
2	Udhëheqës i Divizionit për hart. dhe harm. e legjislacionit	9	523,74	30	27,69	581,42
3	Zyrtar i lartë ligjor	8,5	494,63	30	26,23	550,86
4	Përkthyes dhe lektor	8	465,53	30	24,78	520,30
5	Zyrtar Ligjor - Inspektim	7	407,55	30	21,88	459,43
6	Zyrtar Ligjor -Inspektim	7	407,55	30	21,88	459,43
7	Zyrtar Ligjor - inspektim	7	407,55	30	21,88	459,43
8	Këshilltar Ligjor	7	407,55		20,38	427,93
9	Asistent Administrativ - personel mbështetës	6	348,56		17,43	365,99
	Shpenzimet mujore	Totali	4.045,38	210,00	212,77	4.468,14

Ju njoftojmë se kemi respektuar vendimin e Qeverisë dhe Minsitrisë së Financave mbi prerjen dhe gjendjen e pagave nga muaji qershor 2015 dhe bllokimin për rritje koeficientësh dhe planit të avancimeve. Sidoqoftë, kjo gjendje është e papranueshme që të përcillet edhe në vitin 2016 dhe është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht Ligjin për Shërbimin Civil dhe rregulloret mbi avancimin dhe gradimin brenda shërbimit civil. Agjencia, përveç numrit të vogël të personelit, të angazhuar deri në pesë funksione, në aspektin administrativ dhe operacional, tani ka të bllokuar edhe sistemin për ngritjen dhe avancimin brenda strukturës dhe kjo gjendje nuk mund të vazhdojë sepse personeli mund të demotivohet dhe do të jetë i pamundshëm realizimi i detyrave dytësore pa motivim dhe pamundësi për ti trajnuar dhe barazuar me pagat e institucioneve të pavarura në kuadër të një sistematizimi për të cilat do të jetë përgjegjësi e Kuvendit dhe Komisioneve adekuate.

4.3.2 Paraqitja në Formë Tabelare e Numrit dhe Llojit tëTrajnimeve, Punëtorive dhe Tryezave

Agjencia, gjatë vitit 2015 ka realizuar 18 trajnime, punëtori dhe tryeza të organizuara nga Projekti IPA në pajtim me planin e trajnimeve për vitin 2015. ASHMDHP ka miratuar strategjinë për trajnime për vitin 2014-2016, por në mungesë buxheti nuk kemi mundur të fillojmë zbatimin e trajnimeve të nevojshme e të parashikuara, për të cilat, pjesa kryesore nuk mund të mbahen në vend, për shkak të natyrës së punës në Agjenci.

Tabela 3 – Lista e Trajnimeve, punëtorive dhe tryezave, të realizuara gjatë vitit 2015

Nr	Emërtimi i trajnimit	Vendi	Pjesëmarrësit	Data	Organizatori
1	Tryezë e Rrumbullakët "Balancimi i Mbrojtjes së të Dhënave dhe Lirisë së Informacionit"	Hotel Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	26 janar 2015	IPA projekt & ASHMDHP
2	Tryezë e Rrumbullakët "Mbi problemet në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave"	Hotel Emerald	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	11 shkurt 2015	IPA projekt & ASHMDHP
3	"Trajnim mbi zhvillimin e kapaciteteve për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale"	IPA Projekt	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	04 mars 2015	IPA projekt & ASHMDHP
4	Punëtori: "Mbi projekt-aktin nënligjor për sigurinë e të dhënave"	Hoteli Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	12 mars 2015	IPA projekt & ASHMDHP
5	Punëtori: "Mbi problemet e sigurisë së të dhënave Trajtimi i rasteve"	Hoteli Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	19 mars 2015	IPA projekt & ASHMDHP
6	Punëtori: "Mbi aftësitë e prezantimit publik punëtori mbi aftësitë e prezantimit publik"	Hotel Theranda Prizren	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	31 mars – 2 prill 2015	IPA projekt & ASHMDHP
7	"Trajnim për Auditor Udhëheqës"	Qendra Orion Prishtinë	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	4-8 prill 2015	IPA projekt & ASHMDHP
8	Punëtori: "Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në institucionet financiare në Spanjë"	IPA Projekt	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	24 qershor 2015	IPA projekt & ASHMDHP
9	"Trajnimi i trajnerëve për kurrikulën e përgjithshme të trajnimit të mbrojtjes së të dhënave për ZMDH-të"	IPA Projekt	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	25 qershor 2015	IPA projekt & ASHMDHP
10	"Trajnimin e Sigurisë në TI"	Qendra e trajnimit Cactus	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	11-12 gusht 2015	IPA projekt & ASHMDHP
11	Seminar mbi 'Çështjet e mbrojtjes së të dhënave; roli dhe përgjegjësitë e ZMDH-ve'	Hotel Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	27-28 Gusht 2015	IPA projekt & ASHMDHP
12	Tryezë e rrumbullakët: "Mbi gjendjen aktuale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe Vizionin e zhvillimit të saj"	Hoteli Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	15 shtator 2015	IPA projekt & ASHMDHP
13	Tryezë e rrumbullakët: "Temat kryesore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në institucionet financiare"	Hoteli Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	08 tetor 2015	IPA projekt & ASHMDHP

14	Trajnimi Pilot: Përkurrikulëin e përgjithshme të trajnimit të mbrojtjes së të dhënave për ZMDH-të Punëtori mbi sigurinë e të dhënave trajtimi i rastit	ASHMDHP	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	22 tetor 2015	IPA projekt & ASHMDHP
15	Trajnim: "Trajnim Për Mbikëqyrësit Shtetëror dhe Nëpunësit Civilë në Sektorin e Arsimit të ASHMDhP-së"	ASHMDHP	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	3 nëntor 2015	IPA projekt & ASHMDHP
16	Tryezë e Rrumbullakët: "Problemet e Identifikuara në Sektorin e Arsimit"	Hoteli Sirius	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	4 nëntor 2015	IPA projekt & ASHMDHP
17	Punëtori: „Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Përqendruar avokatët në linjën e ministrive“	ASHMDHP	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	5 nëntor 2015	IPA projekt & ASHMDHP
18	Trajnim "Kurrikula e Trajnimit mbi Çështjet e Mbrojtjes së të Dhënave për Adoleshentët"	ASHMDHP	ASHMDHP ZMDHP (publiko privat)	17 dhjetor 2015	IPA projekt & ASHMDHP

4.3.3 Plani i Trajnimit për Personelin e Angazhuar në Kuadër të ASHMDHP-së për Vitin 2015

Plani i trajnimit për vitin 2015 parasheh nevojat për ngritje të kapaciteteve në aspektin e teknologjisë informative, siguri të përpunimit të të dhënave dhe hartimit të legjislacionit sekondar dhe akteve tjera. Megjithatë, plani i trajnimeve, i cili është aprovuar për vitin 2015, mbulohet nga projekti IPA-së i BE-së "Mbështetje për Institucionet e Kosovës në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale". Pjesëmarrja në këto kurse trajnimi varet nga dy (2) faktorë: disponueshmërisë së fondeve dhe disponueshmërisë së kurseve të trajnimit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto çështje, plani i trajnimit është ndarë në katër pjesë:

- I. Plani i trajnimit për personelin e angazhuar në ASHMDHP, për periudhën janar 2015 – dhjetor 2015, aktivitetet më të rëndësishme të trajnimit, të planifikuar për muaj të caktuar ose një afat për finalizimin e tyre;
- II. Aktivitetet e trajnimit në vendin e punës që janë në vazhdim e sipër, dhe zakonisht ofrohen sipas kërkesës;
- III. Kurse të mëtejshme për shqyrtim, varësisht nga burimet dhe disponueshmëria e kurseve nga ofruesit e trajnimit.
- IV. Trajnimet e organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Ministria e Financave për trajnimet e natyrës administrative dhe financiare

4.3.4 Asetet

4.3.4.1 Asetet në Posedim të Institucionit

ASHMDHP posedon pasuri jofinanciare, e cila është blerë për nevoja pune nga fundi i vitit 2011, donacioneve të pranuar nga Ambasada Norvegjeze, EULEX, dhe Komisioni Evropian (Projekti IPA). Pasuria është e ndarë në dy përmbledhje:

1. Përmbledhja e pasurive jofinanciare me vlerë nën €1000 dhe me afat përdorimi më shumë se një vit, gjithësej 275 artikuj me vlerë të blerjes **€81.987,47** dhe vlera e tanishme pas amortizimit prej **€34.335,53**. ASHMDHP ka pajisjet e nevojshme për punë për numrin momental të zyrtarëve (kompjuterë, printerë, llap-topë, tavolina pune, ormanë, etj);
2. Përmbledhja e pasurive jofinanciare kapitale (me vlerë mbi €1000) në posedim të organizatës buxhetore, gjithësej 19 artikuj me vlerë të blerjes **€160.072,67** dhe vlera e tanishme e pasurisë kapitale pas amortizimit ndër vite në vlerë prej **€117.585,39**.

Vlerat e lartcekura janë prerje në fund të vitit kalendarik dhe financiar 2015, dmth. deri me datën 31.12.2015.

Tabela 4 – Lista e Pasurisë Kapitale në vlerë mbi €1000

Nr.	Emri	Data e blerjes/ doacion	Sasia
1	KIA RIO	19/07/2012	1
2	KIA CEED	19/07/2012	1
3	Digital Sender Flatbed, ADF	26/12/2013	2
4	Dell Poweredge R515, Server RACK	26/12/2013	2
5	Sonic Wall NSA 2400	26/12/2013	1
6	Dell Rack 2420	26/12/2013	1
7	Dell Rack UPS	26/12/2013	1
8	HDD Statin- Fantec 8*4TB	26/12/2013	1
9	Digital Camera Canon EOS 600D	26/12/2013	1
10	Fotocopy Digital MFP Canon IRC35*)NE	26/12/2013	1
11	Notebook	27/01/2014	4
12	Peugeot 3008	27/11/2014	1
13	Peugeot 301	24/12/2014	2
14	Nissan Patrol	21/07/2015	2
15	HP liteboock 840 G1 Notebook PC	27/10/2015	9
16	Printer color HP laserjet enterprise M552	27/10/2015	2
17	Konica Minolta	27/10/2015	1
18	HP LTO5 Ultrium 3000 SAS Ext tape drive	27/10/2015	1
19	16 GB 1600 Mhz DDR3 Dual Rank RDIMM Memory module	27/10/2015	2
			36

4.3.4.2 Planet për Asete të Reja

ASHMDHP është e vendosur në objekt shtetëror dhe objekti ku është e vendosur agjencia gjendet në oborrin prapa Ministrisë së Punëve të Jashtme, gjegjësisht aneksi i objektit të ish APJ-së. Në fund të vitit 2015, nga Ministria e Administratës Publike kemi pranuar hapësira shtesë me lirim të një aneksi nga EULEX-i, të cilat hapësira janë renovuar dhe përshtatur në hapësira për punë (zyra), dhe Agjencia ka vendosur pajisjet e nevojshme për punë (kompjuterë, printerë, tavolina pune, ormanë, etj). Në bazë të kërkesave të vazhdueshme për plotësim të personelit parashikohet të ketë nevojë për blerje të reja të pasijeve për punë dhe shtimin e hapësirave të punës.

5 Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

5.1 Këshilla dhe Opinione

Agjencia ka dhënë këshilla dhe opinione institucioneve publike dhe private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që parashohin përpunimin e të dhënave personale.

Gjatë vitit 2015, Agjencia ka dhënë tetë (8) opinione institucioneve publike dhe private lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.




Figura 2 – Opinionet e dhëna ndër vite

Institucionet të cilat kanë kërkuar dhe kanë marrë opinione nga Agjencia në lidhje me çështjet e lartcekura janë:

- Opinionin në kërkesën e për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Qasje të plotë në Formularët e Publikimit Financiar të Kandidatëve, konkretisht për 120 Deputetët të cilët kanë kaluar pragun zgjedhor.
- Opinionin lidhur me kërkesën e TEB Bankë SH.A.- Kosovë në lidhje me mundësinë e transferimit të të dhënave personale në Agjencinë Mbikëqyrëse Rregullative të Bankave në Turqi.
- Opinion lidhur me kërkesën e Komunës së Gjilanit rreth qasjes në bazën e të dhënave të Gjendjes Civile.
- Opinion lidhur me kërkesën e SBASHK-ut se a është në përputhje marrja e të dhënave nga sistemi i pagave për ndalesat sindikale për anëtarët e SBASHK-ut konform deklaratave të nënshkruara nga ana e anëtarësisë që i dorëzojnë në sistemin e pagave për ndalesat e kuotës së anëtarësisë dhe shumën e ndalesës së anëtarësisë.
- Opinion lidhur me kërkesën për sqarim nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës në lidhje me çështjet se a ka të drejtë, qoftë mbikëqyrësi (BQK) apo Auditori i Jashtëm, të kërkojë të dhënat dhe databazën (që ndërlidhet me auditim) dhe këto të dhëna të u dërgohen jashtë Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në CD apo përmes e-mailit.
A kanë të drejtë të njëjtit të kërkojnë që përmes e-mailit apo CD të i kërkojnë pagat e të gjithë punonjësve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.
- Opinion lidhur me kërkesën për sqarim nga Banka TEB në lidhje me çështjen se a mundet të merret pëlqimi për qasje në regjistrin e kredive (CRK) nëse klienti pajtohet dhe kërkesën e tillë e aprovon përmes formës elektronike duke klikuar në katrorin për aplikimi të kredisë dhe qasjes në CRK të tij?
- Opinion lidhur me kërkesën e Postës së Kosovës në lidhje me çështjet se:
A kanë të drejtë operatorët tjerë që të komunikojnë me konsumatorët – qytetarët duke dërguar, por duke mos i zarfuar dërgesat, faturat, njoftimet e tyre, kur kjo e drejtë është e zonë e rezervuar e operatorit publik postar Posta e Kosovës deri në 500 gram sipas vendimit të ARKEP?

Cilat janë të drejtat e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mbrojtjen e privatësisë nga ekspozimi i të dhënave personale nga këto shërbime që japin subjektet publike dhe private?

Kërkojmë nga ASHMDHP që të na sqarojë ligjërisht që përveç ndërhyrjes në zonën e rezervuar të operatorit publik, respektivisht ndërhyrjes në fushëveprimtarinë e shërbimit postar nga këto subjekte publike dhe private, a janë ekspozuar qytetarët e Kosovës dëmit të madh të shkeljes së privatësisë dhe të dhënave personale?

Cilat janë mundësitë e koordinimit institucional me Agjencinë për inicimin e plotësim/ndryshimit të Ligjit për Shërbimin Postar në mënyrë që të përshtatet më shumë me zbatimin me mbrojtjen e të dhënave personale dhe që si standard i BE-së çdo komunikim me qytetarët përmes njoftimeve, faturave e të ngjashme të jetë i zarfuar/mbyllur?

A konsideroni dhe ju, si Agjenci Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, këtë hapësirë të shkeljes në praktikë nga ana e subjekteve publike dhe private në Kosovë moszbatimin, apo shmangie nga zbatimi i dispozitave ligjore të ligjit në fuqi për Mbrojtjen të Dhënave Personale dhe Privatësisë për qytetarët e Republikës së Kosovës?

- Opinion lidhur me kërkesën për sqarim nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal 'Prishtina' për publikimin e listave të konsumatorëve që do të përfitojnë nga Ligji Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike.
- Koment lidhur me koncept dokumentin për trajtimin e procedurave të inkasimit të detyrimeve doganore për telefonat mobil.

5.2 Këshillat e Drejtpërdrejta nga Mbikqyrësit

Në kuadër të përgjegjësi, mbikqyrësit, gjatë këtij viti, kanë dhënë 36 këshilla institucioneve të ndryshme lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia është përgjegjës për një numri të madh të pyetjeve të ardhura nga masmediat, shoqëria civile, kontrolluesit (publik dhe privat) dhe qytetarët, lidhur me çështjet e ndryshme të ngritura për mdhp.

Këshilla




Figura 3 – Këshillat e dhëna ndër vite

Mbikqyrësit shtetërorë, në vazhdimësi kanë dhënë këshilla të ndryshme gjatë inspektimeve, kontrolleve dhe vizitave që kanë bërë në vitin 2015.

5.3 Konsultim me Rastin e Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative

Në bazë të nenit 39 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale, Agjencia, gjatë vitit 2015, ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimet e saj lidhur me ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë ardhur për konsultim në Agjenci edhe atë: për 6 projektligje, 8 draft-rregullore, 17 udhëzime administrative si dhe 5 akte të tjera, përfshirë këtu memorandume shpjeguese, draft-marrëveshje, memorandume mirëkuptimi, koncept dokumente si dhe akte tjera administrative.




Figura 4 – Konsultimet rreth Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative ndër vite

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimin për këto akte:

Projekt – Ligje

- Projektligji për Sigurimet,
- Projektligji për Faljen e Borxheve Publike,
- Projektligji për Noterinë,
- Projektligji për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës,
- Projekt Ligji për Banim Social,
- Projekt Ligji për Performancën e Energjisë së Ndërtesave

Projekt – Rregullore

- Projekt - Rregullore Nr. xx për Plotësimin e Standardeve të Përgjithshme Themelore të Sigurimit në Aviacionin Civil;
- Projekt - Rregullore (MSH) Nr. xx/2015 për Pagesën e Shtesave për Trupat Administrative – Profesionale;
- Projekt - Rregullore Nr. xx/2015 për Punën e Këshillit Përgatitor për Themelimin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor;
- Projekt - Rregullore Nr. xx/2015 për Mjetet Matëse;
- Projekt - Rregullore (MPMS) Nr. xx/2015 për Funksonimin dhe Punën në Strehimoren për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë;
- Projekt - Rregullore (MPB) Nr.xx/2015 për Procedurat dhe Kushtet e Gradimit për Punonjësit e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;
- Projekt - Rregullore (MI) Nr. 2015/x për Aproximin e Fluturimeve *Charter* dhe *Taxi jo-HPEA*,
- Projekt-Rregullore (MSH) Nr. __/ __ për Arkivin dhe Lëndën Arkivore;

Projekt - Udhëzime Administrative

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 00/2014 për Procedurën e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës me Dekret të Presidentit;
- Udhëzim Administrativ Nr. 0/2014 – MPB për Llojin dhe Sasinë e Informacionit që Mund tu Jipet Institucioneve dhe Organeve Kërkuese;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 00/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes;
- Udhëzim Administrativ QKR - nr. 00/2015 për Procedurat e Faljes së Borxheve Publike;
- Udhëzimi Administrativ për formën dhe Përmbajtjen e Procesverbalit për Mbikëqyrje Inspektive;
- Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 00/2015 për Regjistrimin e Automjeteve;
- Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. __/ __ për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Azbest;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 00/2015 për Regjistrimin e Mëvonshëm në Regjistrat e Gjendjes Civile;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 00/2015 për Pajisje me Letërnjoftim, Pasaportë dhe Patentë Shofer me Procedurë të Përsheptuar;
- Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 00/2015 për Refuzimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës;
- Udhëzimin Administrativ (MSH) Nr. xx 2015 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. xx/2015 për Listën e Autorizuar të Pajisjeve për Qëllime të Veçanta për Institucionet Shtetërore të Sigurisë;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. Xx/2015 për Lejen e Eksportit të Përkohshëm, Verifikimin e Importit nga Përdoruesi i Fundit, Masat e Sigurisë së Institucioneve të Autorizuara Shtetërore për Siguri për Caktimin e Personit Përgjegjës dhe Masat e Sigurisë gjatë Transportit të PQV-së;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 00/2015 për Leje për Lëvizje me Armë;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 00/2015 për Themelimin e Komisionit Shqyrtues dhe Komisionit për Ankesa;
- Udhëzim Administrativ (MSH) Nr. Xx / Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor;
- Udhëzimin Administrativ (MMPH) Nr. __ mbi Fushëveprimin dhe Përgjegjësitë e Institutit për Planifikimin Hapësinor.

Akte Tjera

- 1) Koncept Dokument për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike;
- 2) Koncept Dokument për Qasje në Dokumente Publike;
- 3) Koncept Dokument për Projekt Ligjin e Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- 4) Koncept Dokument për Rregullimin e Profesionit të Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;
- 5) Koncept Dokument për Çështjen e Trajtimin të Ndërtimeve pa Leje.

5.4 Ankesat

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person i cili konsideron se i është shkelur e drejta e tij/saj në privatësi në kuptim të të dhënave personale, mund të parashtrojë ankesë në Agjenci.

Ankesat janë parashtruar gojarisht, përmes telefonit, me shkrim dhe përmes mjeteve tjera të komunikimit elektronik. Agjencia, po ashtu, ka mundësuar që formulari për ankesë të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare. Agjencia, gjatë vitit 2015 ka pranuar gjithsej 131 ankesa. Nga ky numër, për 47 ankesa të qytetarëve është realizuar inspektim dhe është proceduar në harmoni me procedurat dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia ka trajtuar 11 ankesa që ndërlidhen me rrjetin social 'Facebook'. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 21 prej tyre kanë qenë shqetësime të qytetarëve për marketingun e drejtpërdrejtë me qëllim të promovimeve politike.

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë ngritur shqetësimet e tyre kryesisht për përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrollorëve, me ç'rast të dhënat e tyre janë përpunuar me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, zbulimit të paautorizuar të të dhënave, zbulim i paautorizuar i të dhënave personale të ndjeshme, përpunimin e të dhënave biometrike, përpunimi i të dhënave pa pëlqimin e subjektit, përpunimin e të dhënave personale përmes rrjeteve sociale si dhe përpunimi i të dhënave jo të sakta. Këto ankesa kanë qenë kryesisht të orientuara ndaj institucioneve qendrore, institucioneve lokale, sektorit bankar, sektorit mikrofinanciar, kompanive të sigurimeve, sektorit shëndetësor, qendrave tregtare, rrjeteve sociale.

Numri i ankesave është tregues se qytetarët e Republikës së Kosovës kanë njohuri gjithnjë e më shumë në lidhje me të drejtat e tyre të garantuara me ligj. Me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me të drejtat e tyre, Agjencia do të vazhdojë me fushatat ndërgjegjëse edhe në vitet e ardhshme.




Figura 5 – Ankesat e shqyrtuara ndër vite

5.5 Inspektimi dhe Kontrolli

Agjencia bën mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale, i cili realizohet përmes inspektimeve dhe kontrolleve, të cilat, në bazë të ligjit, kryhen drejtpërdrejt nga mbikëqyrësit shtetërorë. Agjencia kryen inspektime të rregullta sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesave. Agjencia ka kompletuar tërë kornizën e nevojshme për realizimin e inspektimeve dhe kontrolleve. Në kuadër të kësaj, Agjencia ka nxjerrë Rregulloren për Inspektim, Listën e Kontrollit dhe Formularin e Procesverbalit. Gjatë vitit 2015 janë kryer gjithësej 131 inspektime, 11 kontrolle, prej të cilave gjashtë (6) lëndë janë proceduar më tutje në procedurë të rregullt gjyqësore për marrjen e masave ndëshkuese administrative. Duke u bazuar në numrin e inspektimeve të viteve paraprake dhe këtij viti, del se numri i inspektimeve është rritur si për nga sasia, po ashtu edhe për nga cilësia, ndërsa numri i kontrolleve nuk është në rritje për arsye se kemi pranuar njoftime paraprake nga kontrolluesit të të dhënave për zbatim të vendimeve.

Inspektime




Figura 6 – Inspektimet ndër vite

5.5.1 Inspektimet

Inspektimet gjatë vitit 2015, kanë pasur këtë shtrirje sipas organeve:

- Organet publike qendrore 27;
- Organet publike lokale 7;
- Organet private 50;




Figura 7 – Inspektimet sipas Institucioneve




Figura 8 – Inspektimet sipas institucioneve ndër vite

Statistikat për llojet e inspektimeve:

- Inspektime të rregullta 73
- Inspektime sipas ankesës 47;
- Inspektime sipas detyrës zyrtare 11




Figura 9 – Inspektimet sipas llojit për vitin 2015

5.5.1.1 Inspektimet e Rregullta

Në vitin 2015 inspektime të rregullta janë realizuar sipas planit të punës për vitin përkatës. Sipas planit të punës për vitin 2015, inspektimet e rregullta kanë qenë të orientuara në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale që nga: ligjshmëria e përpunimit të dhënave personale; siguria e përpunimit të të dhënave personale; transferimi i të dhënave personale në shtetet dhe organizatat ndërkombëtare; përpunimi i të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë; vëzhgimi me kamerë; regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa, përpunimi i të dhënave biometrike dhe ndërlidhja e sistemit të dosjeve.

Disa nga institucionet publike dhe private të cilat janë inspektuar:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria për Forcëne Sigurisë së Kosovës
- Ministria e Drejtësisë
- Banka Qendrore e Kosovës
- Prokuroria e Kosovës
- Ambasada/Konsullata e Republikës së Kosovës në Slloveni
- Universiteti 'Isa Boletini'
- Universiteti 'Haxhi Zeka'
- Universiteti 'Fehmi Agani'
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara
- Universiteti 'Kadri Zeka'
- Komuna e Gjakovës
- Komuna e Prishtinës
- Komuna e Shtimes
- Kompania e Ujësjellësit Rajonal 'Prishtina'
- Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur
- Qendra e Paraburgimit në Prishtinë
- Stacioni i Autobusëve në Prishtinë
- Ndërmarrja Publike Komunale 'Hortikultura'
- Kolegji 'UBT'
- Kolegji 'Pjetër Budi'
- Kolegji 'AAB'
- Kolegji 'Dukagjini'
- Kolegji i Biznesit

- Kolegji 'Iliria'
- Kolegji 'Globus'
- Akademia 'Evolucion' Prishtinë
- 'Western Union'
- 'Exclusive Group'
- 'Albi Group'
- 'Viva Fresh'
- 'Meridian Express'
- Hotel 'Emerald'
- Hotel 'Swiss Diamond'
- Hotel 'Grand'
- Hotel 'Sirius'
- Hotel 'Royal'
- Hotel 'Victory'
- Hotel 'Nartel'
- Hotel 'Afa'
- Hotel 'Baci'
- Hotel 'Parlament'
- Hotel 'Real'
- Hotel 'Begolli'
- Hotel 'Gorenje'
- Hotel 'Sara'
- Hotel 'Glory'
- Hotel 'Pejton'
- Hotel 'Aldi'
- Hotel 'City Central'
- Hotel 'Prishtina'

Gjatë inspektimeve të organeve publike dhe private në fushat e lartcekura janë konstatuar parregullsi, për të cilat, Agjencia, në bazë të të gjeturave, ka nxjerrë vendime, me anë të të cilave institucionet e lartcekura janë urdhëruar apo këshilluar për eliminimin e parregullsive të konstatuara. Inspektimet e rregullta të realizuara sipas planit të punës të vitit 2015 ligjshmëria e përpunimit të dhënave personale; siguria e përpunimit të të dhënave personale; transferimi i të dhënave personale te shtetet dhe organizatat ndërkombëtare; përpunimi i të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë; vëzhgimi me kamerë; regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa, përpunimi i të dhënave biometrike dhe ndërlidhja e sistemit të dosjeve, janë realizuar në pothuajse të gjitha institucionet publike dhe private të vlerësuar nga Agjencia si përpunues të të dhënave personale.

Në fushën e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave janë inspektuar institucionet e lartcekura pas verifikimit të procedurave dhe akteve ligjore dhe nënligjore janë nxjerrë vendime përmes së cilave janë urdhëruar apo këshilluar institucionet që të bëjnë përpunimin e të dhënave personale në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjithashtu mund të konstatojmë se pas realizimit të inspektimit, e më pastaj kontrollit mbi zbatimin e vendimeve, mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave e kanë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Siguria e përpunimit të të dhënave personale ka qenë pjesë e inspektimit në disa nga institucionet e lartcekura, pas realizimit të inspektimit janë nxjerrë vendime përmes të cilave janë urdhëruar apo këshilluar institucione që nxjerrin akte të brendshme për sigurinë e të dhënave personale dhe të emërojnë në formë të shkruar personat kompetentë që përpunojnë të dhëna personale.

Transferimi i të dhënave personale te shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare është vlerësuar nga Agjencia si një sfidë me të cilën duhet të fillohet ballafaqimi në vitin 2015. Me këtë rast institucionet e lartcekura janë inspektuar nëse ky transferim po realizohej në harmoni me ligjin. Agjencia ka marrë paraprakisht vendim mbi listën e shteteve me nivel të duhur të sigurisë së të dhënave personale. Parregullsitë në të cilat është hasur gjatë inspektimit të institucioneve të lartcekura janë përmirësuar pas vendimeve që Agjencia ka nxjerrë për eliminimin e tyre. Në këtë rast, për të gjitha transferimet që realizohen në vendet të cilat janë pjesë e listës së vendeve me nivel të duhur të sigurisë janë këshilluar

institucionet që kontratat apo marrëveshjet të harmonizohen me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ndërsa, për transferimet e të dhënave personale të cilat realizohen në shtetet që nuk kanë nivel të duhur të sigurisë, pas plotësimit të kriterëve ligjore, Agjencia ka dhënë autorizim. Pas kontrolleve të zbatimit të vendimeve mund të konstatohet se të gjitha institucionet e lartcekura, transferimin e të dhënave personale të shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare e realizojnë në harmoni me ligjin.

Marketingu i drejtpërdrejtë përdoret mjaft shumë nga kompanitë private me qëllim të promovimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre, andaj Agjencia, në planin e punës për vitin 2015 ka vendosur të inspektojë institucionet e lartcekura. Gjatë inspektimit janë gjetur parregullsi, që nga dërgimi i e-maileve apo SMS-ve pa marrjen e pëlqimit nga ana e klientit dhe deri te dërgimi i ofertave të ndryshme qytetarëve që nuk kanë qenë klientë të kompanive përkatëse. Në këtë rast, Agjencia ka nxjerrë vendime përmes të cilave ka urdhëruar ndërprerjen e këtyre praktikave dhe në të njëjtën kohë ka këshilluar mënyrën ligjore të përdorimit të të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë. Vlenë të theksohen përmirësimet e dukshme të përdorimit të marketingut të drejtpërdrejtë në sektorin bankar, atë të rrjetit të qendrave tregtare, etj.

Në fushën e vëzhgimit me kamerë janë inspektuar disa nga institucionet e lartcekura dhe pas verifikimit të procedurave dhe dokumentacionit që kërkohet nga ligji, si dhe verifikimi i sistemeve të monitorimit të kamerave të cilat pasqyrojnë pozicionimin e kamerave, janë nxjerrë vendime përmes së cilave janë urdhëruar apo këshilluar institucionet për zbatimin e ligjit në fushën e vëzhgimit me kamerë. Pas inspektimit dhe më pastaj kontrollit mbi zbatimin e vendimeve, mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara kanë instaluar dhe vazhdojnë të përdorin sistemin e vëzhgimit me kamerë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Regjistrimet e hyrje – daljeve nga ndërtesa po ashtu kanë qenë pjesë e planit të punës që të inspektohen në vitin 2015. Gjatë inspektimit janë gjetur parregullsi, që nga marrja e tepër të e të dhënave personale deri te ruajtja e regjistrave përtej afatit të lejuar nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për të gjitha institucionet e inspektuara, në të cilat janë gjetur këto parregullsi, Agjencia ka nxjerrë vendime për eliminimin e tyre. Pas kontrolleve mbi zbatimin e vendimeve mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara mbajnë regjistra të hyrje-daljeve në ndërtesa nga ana e vizitorëve në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duke pasur parasysh se të dhënat biometrike hyjnë në grupin e të dhënave personale të ndjeshme Agjencia ka vlerësuar që në vitin 2015 të bëjë inspektime në këtë fushë. Në të gjitha institucionet e inspektuara të cilat kanë përpunuar të dhëna biometrike, në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka dhënë autorizim për përpunim. Në të gjitha rastet tjera kur të dhënat biometrike janë përpunuar në kundërshtim me ligjin, Agjencia ka nxjerrë vendime përmes të cilave ka urdhëruar ndërprerjen e këtij përpunimi. Pas kontrolleve mbi zbatimin e vendimeve mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara përpunojnë të dhëna biometrike në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5.5.1.2 Inspektimet Sipas Ankesës

Agjencia, gjatë vitit 2015, pas analizimit dhe vlerësimit të ankesave ka realizuar 47 inspektime. Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të ankuesve, janë realizuar inspektimet në institucionet ndaj të cilave është bërë ankesa.

Disa nga institucionet ndaj të cilave është bërë ankesë janë:

- Ministria për Komunitet dhe Kthim
- Ministria e Administratës Publike
- Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
- Dogana e Kosovës
- Komuna e Gjakovës
- Banka 'TEB'
- 'Albi Group'
- Banka 'Raiffeisen'
- Banka Ekonomike
- 'Promokos'
- Administrata Tatimore e Kosovës
- N.P.T. 'Beli'
- Banka 'ProCredit'
- 'JYSK'
- 'Etnikos'
- 'Jumbo'
- 'British School of Kosova'
- Kolegji 'AAB'
- Stacioni i Autobusëve Prishtinë
- Shërbimi Klinik Spitalor i Kosovës
- 'Beni Dona Plast'
- 'Librex'
- Gazeta 'Zëri'
- 'Vala'
- Radio Televizioni i Kosovës

Ankesat kanë qenë kryesisht të fushave: zbulimi i paautorizuar i të dhënave personale, marketingu i drejtpërdrejtë, grumbullimi i të dhënave personale pa bazë ligjore, vëzhgimi me kamerë, etj.

Pas realizimit të inspektimit të institucioneve të lartpërmendura, Agjencia ka nxjerrë vendime, me anë të të cilave, institucionet e lartcekura janë urdhëruar apo këshilluar për eliminimin e parregullsive të konstatuara. Në të gjitha rastet, ankuesit janë njoftuar me rezultatin e inspektimit si dhe me veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë brenda mandatit të saj.

5.5.1.3 Inspektimet Sipas Detyrës Zyrtare (*Ex Officio*)

Agjencia, gjatë vitit 2015 ka realizuar njëmbëdhjetë (11) inspektime sipas detyrës zyrtare. Inspektimet sipas detyrës zyrtare janë bërë kryesisht në bazë të informacioneve për shkeljet e mundshme të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, kryesisht janë marrë nga mediumet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në kuadër të inspektimeve sipas detyrës zyrtare hyjnë edhe inspektimet të cilat bëhen me rastin trajtimit të kërkesave të organeve për marrjen e autorizimeve për përdorim të të dhënave biometrike, transferimin e të dhënave në vendet dhe organizatat ndërkombëtare që nuk sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për secilin rast, Agjencia ka realizuar inspektime në institucionet e mëposhtme për të vërtetuar nëse institucioni përpunon të dhënat personale në harmoni me ligjin.

Institucionet në të cilat janë bërë inspektime sipas detyrës zyrtare janë si më poshtë:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Banka Qendrore e Kosovës
- 'Eli-Ab'
- 'Selman's Network'
- 'Beni Dona Plast'
- MFI 'Start'
- 'Kosinvest'
- 'Five Star'

- Qendra Kosovare për Transfuzion të Gjakut
- Prokuroria e Gjilanit

Inspektimet sipas detyrës zyrtare janë bërë në fushat e vëzhgimit me kamerë, përdorimin e karakteristikave biometrike, zbulimi i paautorizuar i të dhënave personale, qasja në të dhënat personale, marketingu i drejtpërdrejtë, transferimi i të dhënave personale, etj. Pas inspektimit të institucioneve të lartpërmendura, Agjencia ka nxjerrë vendime, me anë të të cilave institucionet e lartcekura janë urdhëruar apo këshilluar për eliminimin e parregullsive të konstatuara.

5.5.2 Kontrolllet

Agjencia, gjatë vitit 2015 ka realizuar gjithësej njëmbëdhjetë (11) kontrolle. Kontrolllet janë realizuar në institucionet, në të cilat, pas inspektimit janë nxjerrë vendime, përmes të cilave është urdhëruar eliminimi i shkeljeve. Në rastet kur Agjencia ka nxjerrë vendime, përmes të cilave institucioni është këshilluar në eliminimin e parregullsive të vogla, Agjencia nuk ka realizuar kontroll pasi që institucioni ka përmbushur këshillën dhe në formë të shkruar është dëshmuar zbatimi i këshillës.

Institucionet në të cilat Agjencia ka realizuar kontrolle janë si në vijim:

- Universiteti 'Haxhi Zeka'
- Universiteti 'Fehmi Agani'
- Komuna e Gjakovës
- Kolegji 'Dukagjini'
- Kolegji i Biznesit
- Kolegji 'Pjetër Budi'
- Qendra Kosovare për Transfuzion të Gjakut
- Kompania e Ujësjetës Rajonal 'Prishtina'
- Stacioni i Autobusëve në Prishtinë
- Akademia 'Evolucion' në Prishtinë

Kontrolle




Figura 10 – Kontrolllet e Realizuara ndër Vite

5.5.3 Përpunimi i të Dhënave Biometrike

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dhënat biometrike konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme dhe si të tilla ato duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

Sektori publik dhe privat mund ti përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerësimin e domosdoshmërisë së përdorimit të të dhënave biometrike e bën Agjencia përmes dhënies së autorizimit për përdorim, përveç rasteve të parapara me ligj.

Të gjitha organet publike dhe private të cilat dëshirojnë të përpunojnë të dhënat biometrike, përveç rasteve të parapara me ligj, para përdorimit të të dhënave biometrike duhet marrë autorizimin nga Agjencia në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vitin 2015 Agjencia nuk ka pranuar asnjë kërkesë për marrjen e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike.

5.5.4 Transferimi i të Dhënave Personale

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera apo në organizata ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm nëse këto vende sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Për të gjitha ato vende apo organizata ndërkombëtare të cilat nuk sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave, organi publik apo privat që dëshiron të bëjë transferim të të dhënave, duhet të ndjekë procedurat e marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Agjencia ka të aprovuar legjislacionin sekondar me të cilin rregullohen procedurat e transferimit të të dhënave personale jashtë vendit. Në kuadër të këtij legjislacioni sekondar, Agjencia ka të aprovuar Rregulloren mbi Procedurat e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale, si dhe formularin i cili duhet të plotësohet me rastin e kërkesës nga ana e institucionit për transferimin e të dhënave.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor si dhe për të kontribuar në krijimin e lehtësive për transferimin e të dhënave, Agjencia, përmes një vendimi formal, ka aprovuar listën e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale dhe për të njëjtat vende nuk kërkohet marrje e autorizimit nga ana e Agjencisë.

Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale përmban shtetet si më poshtë:

- | | | |
|-----------------|------------|-------------|
| • Austri | • Gjermani | • Poloni |
| • Belgjikë | • Greqi | • Portugali |
| • Bullgari | • Hungari | • Rumani |
| • Kroaci | • Irlandë | • Sllovaki |
| • Qipro | • Itali | • Slloveni |
| • RepublikëÇeke | • Letoni | • Spanjë |
| • Danimarkë | • Lituani | |

- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Luksemburg
- Maltë
- Holandë
- Suedi
- Britani e Madhe
- Izrael
- Uruguaj

Shtetet anëtare të “Zonës Ekonomike Evropiane” konkretisht listohen:

- Islandë
- Lihtenshtajn
- Norvegji
- Zvicër

Në mbështetje të nenit 53 (paragrafi 2) “Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave”, ku Komisioni Evropian deri më tani ka marrë këto vendime mbi përshtatshmërinë e mbrojtjes së të dhënave personale në vendet e treta:

- Argjentinë
- Australi
- Andorë
- Kanadë
- Guernsey
- Ishulli i Manit
- Jersey
- Ishujt Faroe
- Zelanda e Re
- Programi “SAFE HARBOUR”

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Agjencia ka publikuar listën e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale në Gazetën Zyrtare dhe në faqen publike të Agjencisë. Në vitin 2015 Agjencia ka pranuar dy (2) kërkesa për marrje të autorizimit për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale dhe ka dhënë dy (2) autorizime për transferimin e të dhënave personale:

- 1) **Türkiye İŞ Bankası A.Ş** – Dega në Kosovë, për lejimin e autorizimit për transferim të të dhënave personale në ‘Türkiye İŞ Bankası A.Ş’ – Stamboll, Republika e Turqisë.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga kërkuesi, Agjencia ka konstatuar se janë plotësuar kriteret të parapara në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka lejuar autorizimin për transferimin e të dhënave personale;
- 2) **Banka TEB Sh.A.** – Dega në Kosovë për lejimin e autorizimit për transferim të të dhënave personale në ‘Proventus Bilişim Hizmetleri A.Ş’ me seli në Republikën e Turqisë.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga kërkuesi, Agjencia ka konstatuar se janë plotësuar kriteret të parapara në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka lejuar autorizimin për transferimin e të dhënave personale;

5.6 Informimi dhe Promovimi

Në kuadër të planit të punës, Agjencia edhe gjatë vitit 2015, rëndësi të posaçme ka vazhduar t’i kushtojë komunikimit me publikun. Në këtë kuadër, të gjitha mediumet e shkruara dhe elektronike vendore kanë qenë të informuara me kohë për çdo aktivitet të planifikuar nga Agjencia, duke shfrytëzuar për këtë web faqen e Agjencisë, faqen zyrtare të saj në *Facebook* dhe *Twitter*, si dhe kontaktet e drejtpërdrejta.

Pas përmbylljes së punës sensibilizuese, Agjencia organizoi *Javën e Privatësisë*, në kuadër të së cilës u organizua një Tryezë e Rrumbullakët me temën ‘Balancimi i Mbrojtjes së të Dhënave dhe Lirisë së Informimit’, e cila, një ditë më vonë u pasua me Konferencën Rajonale ‘Privatësia në Epokën Dixhitale’, për ta mbyllur me shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Privatësisë.

Tryeza e Rrumbullakët mbledhi panelistë nga Komisioni i Pavarur i Mediemeve, Këshilli i Mediemeve të Shkruara të Kosovës, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Policia e Kosovës, Qendra për Politika dhe Avokim, BIRN, Avokati i Popullit, Lëvizja FOL, Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë, etj.

Pjesë të panelit, përveç të emrave të lartcekur po ashtu ishin përfaqësues vendorë nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Policia e Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Kolegji UBT, Iliria, përfaqësues nga operatori Vala, Darts, etj, prezantimet e tyre në një formë ose tjetër kishin të bënin me mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimi i teknologjisë në kohën moderne të dixhitalizuar.

Në mbyllje të Javës së Privatësisë, ku njëkohësisht u shënua dhe “Dita Ndërkombëtare e Privatësisë”, u mbajt një seancë e prezantimeve nga përfaqësuesja e Facebook, përfaqësuesi nga autoriteti homolog bullgar, ai nga Mali i Zi, etj. Si pjesë e dytë e konferencës ishte prezantimi i punimeve të nxënësve të shkollave pjesmarrëse në këtë projekt, ku njëkohësisht u bënë edhe vlerësimet e punës simuluese që bënë hakerët etikë në zbulimin e brishtësive të web faqeve të caktuara. Ekipet e nxënësve që kishin zhvilluar fushatë vetëdijesuese me moshatarët e tyre, u shpërblyen me bursa studimi, teknologji informative, libra, trajnime, e kështu me radhë.

Në javën e dytë të shkurtit, Agjencia u përfaqësua me temën ‘Privatësia dhe Përdorimi i Internetit nga Fëmijët’ në aktivitetin e përvitshëm të Qendrës për Arsime të Kosovës dhe Qendrës për Studime të Avancuara ‘FIT’ në shënimin e Ditës së Internetit të Sigurtë.

Nën kryesimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Informacionit të Republikës së Shqipërisë, më 29 dhe 30 prill 2015, në Hotelin Adriatik të Durrësit, u mbajt takimi i 17-të i autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore. Punimet e këtij takimi i zhvilluan duke qenë të përqendruara në temën ‘Privatësia dhe Teknologjia: Sfidat dhe Mundësitë’. Vlenë të theksohet se gjatë punimeve të këtij takimi, Agjencia, me shumicën e votave të autoriteteve të pranishme u anëtarësua në forumin e autoriteteve homologe të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Në një bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e BE-së në Prishtinë të realizuar përmes Projektit IPA, më 30 Qershor 2015 Agjencia, shënoi 4 vjetorin e themelimit të saj. Organizimi i këtij

përvjetori u karakterizua me një konferencë të shkurtë, ku u shpalosën para publikut të arriturat e deritanishme të këtij autoriteti, si dhe sfidat që e presin atë në të ardhmen.

Në kuadër të kësaj konference, u ndanë mirënjohje për pesë zyrtarët mbrojtës më të përkushtuar gjatë këtij viti, të cilët përfaqësojnë institucione publike dhe private. Veç kësaj, Agjencia, këtë vit ndau çmimin 'Zyrtari i Vitit', duke e shpërblyer me një plaketë zyrtare e Agjencisë znj. Medlinë Ademaj në vlerësim të përkushtimit të shquar në punë. Për dallim nga përvjetorët tjerë, Agjencia, në sajë të manifestimeve të këtij përvjetori, organizoi edhe një aktivitet fushor në Sheshin 'Zahir Pajaziti', ku punonjësit e Agjencisë komunikuan me kalimtarët e rastit, të cilëve u shpërndanë materiale promovuese të Agjencisë, si dhe një pyetësor me qëllim të hulumtimit të opinionit publik lidhur me njohuritë e tyre rreth fushëveprimtarisë së Agjencisë dhe të drejtave të qytetarëve mbi privatësinë.

Në vazhden e diskutimeve të vazhdueshme me ekspertë ndërkombëtarë, të angazhuar nga Komisioni Evropian rreth zhvillimeve aktuale në Agjenci, si dhe lidhur me mundësinë e inicimit të ndryshimeve brenda strukturës së saj, Zyra e BE-së, përmes Projektit IPA, në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë, organizoi tryezën e radhës me të ftuar nga institucione shtetërore si dhe nga shoqëria civile.



Figura 11 - Pamje nga tryeza e udhëhequr nga ekspertja e jashtme znj. Natasha Pirc

Qëllim shtesë i kësaj tryeze ishte nxitja e diskutimeve mbi vizionin, objektivat e përgjithshme dhe specifike të strategjisë për periudhën 2017-2021, duke përfshirë këtu ligjet sektorale që do të zbatohen, nevojat e mëtejme për ndërtimin e kapaciteteve etj. Diskutimet e kësaj tryeze shënuan vetëm fillimin e debatit të nisur për shqyrtimin e mundësive për amandementimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si rrjedhojë e ndjekjes së trendit ndërkombëtar të zhvillimeve brenda institucioneve homologe.

Në kuadër të lancimit të fushatës një javore, e cila u zhvilluar në fillim të muajit shtator në gjashtë komunat më të mëdha të vendit (Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjakovë), Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke ngritur dy stenda në hapësirat më të frekuentuara, që në orët e para të mëngjesit fillonte komunikimin e

drejtpërdrejtë me qytetarë duke u shpërndarë materiale promovuese (fletëpalosje, broshura, kapela, flamuj etj., me llogo të Agjencisë dhe mbishkrimin 'Kujdestari i Privatësisë').



Figura 12 - Pamje nga fushata vetëdijesuese në Mitrovicë

Qëllimi i kësaj fushate ishte vetëdijesimi i qytetarëve rreth të drejtave të tyre (si subjekte të të dhënave personale) mbi privatësinë. Zyrtarët e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përmes kësaj fushate simbolike, e dhanë edhe një provë shtesë se autoriteti i vetëm i mandatuar për të mbrojtur privatësinë e qytetarëve është i përkushtuar që t'i trajtojë të gjitha ankesat e tyre, duke e shtrirë ndikimin e saj te përpunuesit e të dhënave personale, që këto të fundit t'i përpunojë në mënyrë të ligjshme, të paanshme, duke mos e cenuar privatësinë e askujt.

Në gjysmën e dytë të muajit nëntor, në bashkëveprim me MASHT dhe mbështetjen e OSBE-se, Agjencia promovoi udhëzuesin e parë rreth kriterëve të vëzhgimit me kamera për të gjitha nivelet e institucioneve arsimore, me ç'rast organizoi konferencë për shtyp me përfaqësuesit e medimeve elektronike dhe të shkruara.



Figura 13 - Pamje nga Promovimi i Udhëzuesit rreth Kriterëve të Vëzhgimit me Kamera në Institucionet Arsimore

Ndër tjera, u vlerësua që pas shpërndarjes së këtij udhëzuesi nëpër institucionet parashkollore, shkollore të të gjitha niveleve, si dhe në ato të arsimit të lartë, do të bie numri i ankesave për shkelje të privatësisë, i cili po paraqitet si rrjedhojë e aplikimit pa kriterë të vëzhgimit me kamera të sigurisë.

Me qëllim të ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe private mbi obligimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka vazhduar gjatë gjithë vitit me organizim të seminareve ndërgjegjëse dhe ka dhënë kontributin në të gjitha organizimeve që janë organizuar me temat në mbrojtjen e të dhënave personale.

Për të qenë sa më pranë publikut, Agjencia ka shfrytëzuar relacionet e krijuara me komunitetin e gazetarisë që me rastin e çdo ngjarjeje të veçantë të organizuar prej saj të ketë përfaqësuesit e saj të ftuar në cilësinë e mysafirëve në mediumet publike e private, si TV dhe radio, me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut rreth çështjes së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia ka organizuar gjatë tërë vitit 2015 konferenca, seminare, trajnime dhe punëtori me organet publike dhe private me temat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale. Me qëllim të ndërgjegjësimit të institucioneve për obligimet ndaj Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka organizuar seminare ndërgjegjëse. Në seminarët ndërgjegjëse të organizuara nga Agjencia, pjesëmarrës kanë qenë shumica e zyrtarëve të institucioneve publike dhe private të cilët në një formë apo formë tjetër kanë qasje në të dhëna personale.

Gjatë vitit 2015 me tema të ndryshme të mbrojtjes së të dhënave personale, janë bërë tridhjetë e katër (34) publikime në web faqen zyrtare të Agjencisë dhe në llogarinë zyrtare të saj në *Facebook*, të cilat kanë pasur për qëllim njoftimin e publikut rreth aktiviteteve të përgjithshme të këtij autoriteti si dhe informimin e qytetarëve për risitë në vend dhe nga bota lidhur me çështjet e privatësisë. Shkrimet e karakterit njoftues janë publikuar kryesisht në ueb faqen zyrtare të Agjencisë, por nuk kanë munguar edhe shkrimet e publikuara në portalet elektronike dhe gazetatat ditore, varësisht nga ngjarjet që ka organizuar apo në të cilat është përfaqësuar Agjencia.

Edhe gjatë këtij viti është ndërmarrë një nismë për ristrukturimin e web faqes zyrtare të Agjencisë, e cila, përveç dizajnit, është pasuruar edhe me rubrika të reja, që të jetë sa më lehtë e shfrytëzueshme nga ndjekësit dhe publiku.

5.7 Bashkëpunimi Vendor dhe Ndërkombëtar

Duke e pasur si objektiv prioritar shtrirjen e bashkëpunimit me autoritetet homologe rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe me organizatat evropiane e ndërkombëtare të cilat merren me promovimin e të drejtës së privatësisë, Agjencia ka qenë aktive, duke u prezentuar në të gjitha forumet në të cilat ka status të definuar, si dhe në punëtoritë me tema të ndërlidhura me mbrojtjen e të dhënave personale.

Pjesë e aktiviteteve publike të Agjencisë, në sajë të bashkëpunimit ndërkombëtar gjatë vitit raportues ishte edhe përfaqësimi i saj në punëtorinë mbi mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të huaj, të organizuar nga Ministria e Brendshme dhe Drejtorati për Mbrojtjen e

të Dhënave Personale i Republikës së Maqedonisë në Shkup. Qëllimi i kësaj ngjarjeje ishte përmirësimi i njohurive mbi Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit dhe njëkohësisht rritja e vetëdijesimit rreth kërkesave të lidhura me mbrojtjen e të dhënave. Për të përfituar nga ekspertiza e përfaqësuesve të shteteve evropiane, ishin ftuar përfaqësues të sektorit të sigurisë së shteteve të rajonit, si: Shqipëria, Kosova, Turqia, Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Serbia.

Përveç axhendës së ditës së parë, gjatë së cilës u paraqitën me prezentimet e tyr ekspertë nga Belgjika, Polonia, Austria, Gjermania, Çekia e Bullgaria, në ditën e dytë ishin paraparë prezente nga përfaqësuesit e shteteve të rajonit, ku Kosova u përfaqësua nga tri institucione: Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës.

Për më tepër, javën e fundit të muajit maj, përfaqësues të Agjencisë morën pjesë në punimet e Punëtorisë 'Ditët e Avokimit të Publikimit të të Dhënave Personale' të mbajtur në Sarajevë në organizim të Ambasadës Amerikane dhe asaj Britanike.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, gjatë mesit të muajit qershor, zyrtarët e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale morën pjesë në vizitën studimore në Sofje. Vizita Studimore është mbështetur financiarisht nga Projekti IPA/BE në bashkëpunim me *Human Dynamics* dhe nga autoriteti homolog bullgar.

Atje u prezantua organizimi i autoritetit bullgar, si dhe disa raste të cilat janë trajtuar prej tyre. Ditën në vazhdim është vizituar Gjykatën Kushtetuese të Bullgarisë dhe *Alpha Bank*, ku në të gjitha takimet u diskutua rreth mbrojtjes së të dhënave personale, menaxhimi i të dhënave personale në sektor të veçantë dhe transferimi i tyre, duke përfshirë edhe rastet e veçanta në ruajtjen e të dhënave personale.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në fund të shtatorit u prezentua në punëtorinë e organizuar në Tiranë nga Komisioneri për Informim dhe Mbrojtje të të Dhënave i Shqipërisë. Punëtorja e 27-të me radhë e karakterit ndërkombëtar shpalosi trajtimin e rasteve specifike nga autoritetet evropiane, me ç'rast nga Agjencia u elaborua tema mbi trajtimin e rasteve të përpunimit të të dhënave biometrike në Kosovë. Prezentimin në gjuhën angleze në emër të delegacionit të Kosovës, mes tjerash, u përqendrua në ndarjen e përvojës me kolegët nga shtetet evropiane në trajtimin e rasteve të përpunimit të të dhënave biometrike në sajë të pajisjeve të teknologjisë së avancuar, kur të dhënat personale nuk ruhen nëpër serverët e kontrolluesit të të dhënave, por subjekti i të dhënave i bartë këto të dhëna me vete. Ky aktivitet u mbështet edhe nga zyra qendrore e OSBE-së, për Demokratizim e vendosur në Kosovë.



Figura 14 - Pamje nga Punëtorja 27-të Ndërkombëtare e Trajtimit të Rasteve në Tiranë

Midis shumë organizimeve tjera nga institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare vendore, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në sajë të bashkëpunimit ndërinstitucional, në ditët e fundit të teorit mori pjesë në tryezë e organizuar nga Organizata Joqeveritare “Drejtësia dhe Qytetarët” si dhe Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).



Figura 15 - Pamje nga tryeza me temën ‘Drejtësia dhe Qytetarët’

Kjo tryezë u organizua me qëllim të promovimit të transparencës në qeverisje të institucioneve ekzekutive si dhe atyre të drejtësisë, me ç’rast u shpalosën paditë e ngritura nga BIRN kundër Zyrës së Kryeministrit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës për shkak të refuzimit të kërkesave për shpenzimet e zyrtarëve të lartë të institucioneve të shtetit.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në sajë të trajnimeve të planifikuara për periudhën e muajit nëntor, bashkë me Projektin IPA të BE-së, ka vazhduar trajnimin me temën rreth mbrojtjes së të dhënave në fushën e arsimit. Në këtë trajnim njëditor kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe ata të universiteve shtetërore e private. Ky cikël i trajnimeve është përmbyllur me pjesëmarrës e përfaqësues të zyrave ligjore nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Në javën e tretë të nëntorit, përfaqësues të ASHMDHP-së kanë marrë pjesë në Konferencën “QASJA NE DOKUMENTA ZYRTARE”, e cila u organizua në Podgoricë të Malit të Zi. E ndihmuar nga OSBE-ja. Këtu, Agjencia u përfaqësua nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror përmes një fjalimi të rastit.

Agjencia ka bashkëpunuar ngushtë me BE në Prishtinë, OSBE, shoqërinë civile, institucionet qendrore dhe lokale, institucionet e sigurisë dhe sundimit të ligjit duke qenë pjesë dhe kontribuar në aktivitete të përbashkëta në tryeza, punëtori dhe konferenca të ndryshme.

Agjencia, në objektivat e vitit 2015, mes tjerash, në fokus ka pasur zgjerimin dhe thellimin e kontakteve, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit në nivel ndërkombëtarë dhe organet e Bashkimit Evropian. Pjesëmarrja në Konferencën Pranverore të Autoriteteve Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të organizuar nga Komisioneri për Informim i Britanisë së Madhe e mbajtur në Manchester në maj 2015 ishte ngjarja e parë e rëndësishme e këtij viti, ku Agjencia u përfaqësua nga drejtori për marrëdhënie me jashtë.

5.8 Bashkëpunimi me Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave

Aktivitetet bashkërenduese të zhvilluara përmes zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave të akredituar nëpër institucionet publike e private janë dëshmuar shumë praktike dhe frutdhënëse. Gjatë përvojës katërvjeçare është konstatuar se të gjitha institucionet të cilat kanë caktuar ZMDH, jo vetëm që kanë treguar përkushtimin e respektimit të dispozitave ligjore për përcaktim të zyrtarit, por është vënë re dhe vullneti i tyre për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në respektimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke veçuar me këtë rast dhe angazhimin e madh të shumicës së ZMDH për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, që jo rrallë ka rënë ndesh me politikat e organit të cilin e ka përfaqësuar.

Për dallim nga praktikat e viteve të mëparshme, gjatë vitit raportues, mbikëqyrësit e Agjencisë kanë filluar së aplikuari një linjëveprim të drejtpërdrejtë të komunikimit dhe bashkëveprimit me zyrtarët mbrojtës, duke zhvilluar takime më të shpeshta pune tek institucionet ku ata punojnë me detyrë primare.

Në një punëtori të organizuar në fillim të qershorit në Gjilan nga OSBE në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u konstatua se mungesa e njohurive përkatëse të zyrtarëve rreth ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe publikimin e tyre, ka shtyrë OSBE-në që të organizojë këtë punëtori në disa komuna të Kosovës për të shpërndarë sa më shumë informacione bazi rreth kësaj çështjeje.

Në vazhdimësi të tryeza me zyrtarë mbrojtës, në javën e fundit të gushtit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një seminar për dy ditë radhazi me rreth 50 zyrtarë mbrojtës të institucioneve publike dhe private.

Ligjeruese në cilësinë e ekspertes së jashtme në temat mbi rolin dhe përgjegjësitë e zyrtarit mbrojtës ishte znj. Rosana Lemut - Strle, ish Zëvendës Komisionerja për Informim e autoritetit homolog sloven.



Figura 16 - Pamje nga seminari me zyrtarët mbrojtës nga institucionet bankare

Programi i seminarit të karakterit trajnues ishte ndarë në dy ditë. Në ditën e parë morën pjesë 26 zyrtarë mbrojtës kryesisht nga institucionet publike, ndërsa në ditën e dytë ishin 22 zyrtarë, kryesisht nga sektori publik, respektivisht nga institucionet bankare. Përveç ligjeratave me tema të përzgjedhura enkas për t'i zbërthyer detyrat specifike të zyrtarëve mbrojtës brenda institucioneve ku punojnë dhe në raport me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pyetjet e shpeshta dhe diskutimet e ndjekësve të këtij seminarit i dhanë qasje ndërvepruese punimeve.

Në javën e parë të tetorit, në organizim të projektit të BE-së "Mbështetje për Institucionet e Kosovës në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale" në bashkëpunim me ASHMDHP-në është realizuar punëtorja që për qëllim kishte të ndajë përvojat në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave nga bankat dhe institucionet financiare. Nga Agjencia u bë një prezantim i shkurtër nga fushveprimtaria e saj në sektorin bankar dhe ai financiarë.



Figura 17 - Pamje nga punëtorja për bankat dhe institucionet financiare

Për të shkëmbyer përvojat në këtë fushë protagonist kryesor i kësaj tryeze ishte përfaqësuesi nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Spanjë z. Luis De Salvador.

Me temën mbi sigurinë e të dhënave personale, Agjencia, në bashkëpunim me projektin e Zyrës së BE-së në Kosovë ‘Mbështetje për Institucionet e Kosovës në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale’, në javën e tretë të tetorit ka mbajtur trajnimin për zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të institucioneve të ndryshme.



Figura 18 - Pamje nga trajnimi me zyrtarë mbrojtës

Ligjërues i këtij trajnimi ishte Dr. Stefan Szysko / ekspert , i cili, për disa nga zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave të institucioneve publike e private shpalosi informacione të shumta praktike mbi sigurinë e të dhënave. Duke analizuar raste konkrete, ai solli praktikat e veprimit në rastet e rrezikut gjatë përpunimit të të dhënave apo edhe keqpërdorimit të tyre. Për këtë trajnim, zyrtarët mbrojtës janë pajisur me certifikatë si ndjekjes të trajnimit “Siguria e të Dhënave”.

Vlen të theksohet se gjatë periudhës njëvjeçare, DRMJ ka pranuar gjashtë (6) vendime për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale, prej të cilëve tre (3) nga institucionet publike dhe tre (3) nga kompanitë private. Me këtë mund të konstatohet se të gjitha institucionet publike qendrore dhe lokale kanë caktuar zyrtarin e brendshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

5.9 Regjistrimi i Sistemit të Dosjeve

Agjencia, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është e obliguar që të themelojë dhe të mbajë një regjistër të sistemit të dosjeve. njoftime Brenda vitit 2015, nga 22 kontrollues kanë sjellur 84 njoftime për regjistrimin e sistemit të dosjeve nga kontrolluesit e sektorit privat.

Në kuadër të të hyrave të regjistruara nga ASHMDHP të gjeneruara nga njoftimet për regjistrim nga subjektet kontrolluese, ‘Neptun’ SHPK ka bërë dy (2) pagesa; njëra për dosjet e aktivitetit të shitjeve në shumë prej €100, tjetra për dosjet e burimeve njerëzore në vlerë prej €20.

Nga kontrolluesit publikë, gjatë vitit 2015, Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, në emër të dosjeve të kategorizuara si dosje të komisionit diciplinor, ka bërë pagesën prej €1 në saje të procedurës së regjistrimit të filluar në vitin 2014.

5.10 Vëzhgimi me Kamerë

Në saje të një bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në javën e dytë të qershorit organizoi një punëtori tri ditore në Pejë të mbështetur nga OSBE-ja, në të cilën, pjesëmarrësit prodhuan një udhëzues për sistemet e vëzhgimit me kamerë.




Figura 19 - Pamje e kopertinës së udhëzuesit

Përveç pjesëmarrësve të Agjencisë, për hartimin e këtij udhëzuesi, kontribut dhanë edhe përfaqësues të MASHT dhe Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë. Udhëzuesi ishte ide e lancuar qysh në fushatën e vitit të kaluar me shkollat e mesme, e cila ishte nxjerrë si konkluzion i të gjeturave të ekipit të Agjencisë se vëzhgimi me kamerë po aplikohet pa kritere. Ky udhëzues adreson nevojat e sigurisë së institucioneve arsimore, duke respektuar dhe ruajtur privatësinë individuale, i cili do të aplikohet nga i tërë personeli i institucioneve arsimore në përdorimin e kamerave të sigurisë dhe në sistemet e monitorimit e video inçizimit të tyre.

Përmes përcaktimit të këtyre kritereve rregullohet çështja e përdorimit të sistemit të kamerave që shfrytëzohen për vëzhgimin dhe inçizimin e hapësirave të institucioneve arsimore për qëllime sigurie.

Vlenë të theksohet se ky publikim plotëson një boshllëk në aplikimin e vëzhgimit me kamera në sektorin e arsimit, zbatimi i të cilit do të bëjë që institucionet arsimore të ofrojnë mbrojtjen e pronës dhe të ofrojnë siguri personale bazuar në kriteret ligjore, duke mos e

shkelur privatësinë e individit, si e drejtë e garantuar me ligj. Departamenti për Demokratizim i OSBE-së mbështeti financiarisht punëtorinë e lartpërmendur.

5.11 Projekti IPA

Agjencia, që nga janari i vitit 2014 mbështetet nga projekti IPA (projekt i financuar nga BE, me nr. Ref. EuropeAid/133806/c/SER/XK), në fushën e Mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbështetja për institucionet e Republikës së Kosovës për periudhën dyvjeçare 2014 – 2016.

Projekti ka vlerën prej €1.349.500,00 dhe është një përpjekje njëzetë e katër (24) mujore për ngritjen e kapaciteteve, ku objektivi i përgjithshëm është mbështetja e autoriteteve të Kosovës në fuqizimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë.

Projekti ka për qëllim të mbështesë ASHMDHP-në në funksionalizimin e plotë të saj dhe në zbatimin me efikasitet të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante dhe fuqizimin e kapaciteteve të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe zyrtarëve të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale për institucionet publike dhe private.

Agjencia ka bërë kërkesë për vazhdimin e projektit IPA nga Komisioni Evropian, sepse pa mbështetje financiare dhe të kapaciteteve njerëzore të Projektit IPA, nuk do të mund të vazhdojmë me buxhetin minimal të aprovuar nga institucionet përkatëse.

5.12 Raporti i Progresit 2015 për Kosovën nga Komisioni Evropian

Raporti i Progresit i vitit 2015 për Kosovën nga Komisioni Evropian, në pikën 4.3.6 për mbrojtjen e të dhënave personale thekson se:

“Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të këtij viti, fusha e mbrojtjes së të dhënave personale gjendet në fazën e hershme të zhvillimit, në të cilën autoriteti i mandatuar (ASHMDHP) jep kontributin e tij në zbatimin e standardeve evropiane. RP thekson se ekziston nevoja për të përforcuar kapacitetet e saj, përfshirë shtimin e stafit të kualifikuar dhe burimeve financiare. Gjithashtu, potencohet themelimi dhe rregullimi i kornizës ligjore dhe institucionit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave dhe qasjes në dokumente publike. Sipas Raportit, nga 38 komunat e Kosovës, 35 sosh kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale. ASHMDHP, thuhet të ketë rritur numrin e inspektimeve, si dhe numri i ankesave të jetë shtuar dukshëm, duke përmendur këtu edhe ngritjen e vetëdijes së publikut.”

Nga raporti i progresit mund të konkuldohet se është vlerësuar puna e Agjencisë gjatë kësaj periudhe si dhe janë dhënë rekomandime për avancim të mëtutjeshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike. Sa i përket qasjes në dokumente publike dhe propozimeve për ndryshim të ligjit, ne kemi dhënë kontributin tonë në tryezat e organizuara nga OSBE, Zyra e Kryeministrit si dhe kemi nxjerrë rekomandime bashkë me ekspertët e Komisionit Evropian – BE (Projektit IPA).

Është me rëndësi të ceket se të gjitha rekomandimet e ngritura në raportin e progresit janë përmbushur nga Agjencia, përveçshtimit të personelit dhe buxhetit për të cilat Agjencia i ka drejtuar mbi pesë (5) kërkesa për buxhet shtesë në institucionet përkatëse.

6 Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Si rrjedhojë e zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit, internetit, rrjeteve sociale, ngritjes së vetëdijes së qytetarëve etj., mbrojtja e të dhënave personale po bëhet gjithnjë e më sfiduese. Kjo ka rezultuar që në këtë vit aktivitetet e Agjencisë të kenë rritje të numrit të inspektimeve dhe numrit të ankesave të qytetarëve.

Numri total i inspektimeve në këtë vit ka qenë njëqind e tridhjetë e një (131), që krahasuar me numrin e inspektimeve nga viti paraprak kemi një rritje prej 15%.

Inspektimet e rregullta janë realizuar kryesisht në fushat: ligjshmëria e përpunimit të dhënave personale; siguria e përpunimit të të dhënave personale; transferimi i të dhënave personale te shtetet dhe organizatat ndërkombëtare; përpunimi i të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë; vëzhgimi me kamerë; regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa, përpunimi i të dhënave biometrike dhe ndërlidhja e sistemit të dosjeve. Është me rëndësi të theksohet se në shumicën e institucioneve që Agjencia ka identifikuar si përpunues të mëdhenj në fushat e lartëcekura inspektimet janë pothuajse të përfunduara.

Sipas rasteve janë realizuar edhe 11 kontrole për verifikimin e zbatimit të vendimeve. Vlenë të theksohet se kemi marrë njoftimet paraprake nga kontrolluesit e të dhënave për zbatimin e vendimeve tona.

Në rastet kur Agjencia ka konstatuar shkelje të cilat nuk mund të përmirësohen si dhe në rastet kur kontrollorët nuk kanë zbatuar vendimet, lëndët janë proceduar më tutje në gjykatën kompetente për masa ndëshkimore, që gjithësej janë gjashtë (6) lëndë.

Duke iu referuar informimit të qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre të garantuara për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka realizuar disa fushata ndërgjegjëse dhe informuese. Në vitin 2015 është përfunduar fushata me temën "Privatësia në Epokën Dixhitale" të filluar në vitin 2014 dhe ka filluar fushatën tjetër më afër qytetarit ku janë vizituar të gjitha regjionet dhe janë shpërndarë materiale njoftuese për qytetarët. Angazhimi i Agjencisë në këtë fushë ka rezultuar me rritjen e ankesave dhe pyetjeve të qytetarëve referuar vitit paraprak. Kështu, në këtë vit kemi 131 ankesa, që është 6.5% ankesa më shumë se vitin paraprak.

Dhënia e komenteve lidhur me masat legislative dhe administrative ka vazhduar sipas kërkesave të institucioneve.

Pas përgatitjeve teknike dhe ligjore ka filluar regjistrimi i njoftimeve të sistemeve të dosjeve.

Agjencia ka certifikuar personelin e nevojshëm dhe ka filluar inkasimin sipas tarifave të përcaktuara në rregulloren për regjistrim.

Procesi i caktimit të zyrtarëve të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale është pothuajse i përfunduar në organet publike qendrore dhe lokale. Pas trajnimeve të këtyre zyrtarëve është rritur bashkëpunimi në mes të Agjencisë dhe organeve publike dhe private, si rrjedhojë është rritur mundësia që Agjencia të jetë proaktive në parandalimin e shkeljeve të mundshme.

Me qëllim që Agjencia të jetë pjesë e nismave rajonale dhe ndërkombëtare, kemi të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha vendet e rajonit (me përjashtim të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës), si dhe me disa vende evropiane. Jemi të anëtarësuar në shumë mekanizma rajonale dhe ndërkombëtarë, në disa si anëtare e përhershme dhe në disa si vëzhguese. Anëtarësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet e rajonit dhe ato evropiane do të jetë prioritet i Agjencisë edhe në vitet e ardhshme. Tani kemi përafëruar raportet me autoritetin homolog të Bosnjës dhe Hercegovinës, ku deri tani jemi angazhuar bashkërisht në disa nisma rajonale dhe ndërkombëtare.

Agjencia, për vitin 2016 ka aprovuar planin e punës. Në kuadër të prioritetëve për vitin 2016 do të jetë vazhdimi i inspektimeve dhe kontrolleve. Do të vazhdohet me fushatat senzibilizuese me qëllim të informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë përmes trajnimit të nëpunësve dhe marrjes së përvojave të vendeve tjera.

Sfidë e vazhdueshme e realizimit të objektivave të Agjencisë është buxheti i kufizuar dhe numri i zyrtarëve për zbatimin e ligjit.

Do të vazhdohet me aktivitetet përmes projektit IPA - BE në trajnimin e stafit në mbrojtjen e të dhënave në sektorë të ndryshëm si dhe aktivitete tjera të përshkruara në projekt.

Agjencia rekomandon që çështja e raportimit të të dhënave personale nga institucionet shëndetësore që kryejnë frytnimin e asistuar mjekësor të rregullohet me ligj në Komisionin për Fertilizimin e Asistuar Mjekësorë, pasi që deri më tani kjo çështje është rregulluar në nivel të udhëzimit administrativ të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë bazuar në Ligjin Nr.02/L-76 për Shëndetin Riprodhues.

Veç kësaj, Agjencia, gjatë periudhës raportuese ka pranuar shumë kërkesa të ndërlidhura me të drejtën e qasjes në dokumente publike. Bazuar në mandatin aktual të Agjencisë, që është mbikëqyrja e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale, si dhe, duke u nisur nga fakti që shumë autoriteteve homologe në rajon e më gjerë i është dhënë/besuar zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike si mandat shtesë, rekomandojmë që në amandamentimet e pritura për Ligjin për Qasje në Dokumente Publike të definohet kompetenca e Agjencisë lidhur me këtë fushë.

Mungesa e saktësisimit të kategorive të të dhënave personale të nevojshme për përpunimin e të dhënave personale nga ana e organeve publike dhe private është një ndër mungesat më të mëdha të legjislacionit në fuqi. Mungesa e këtij përcaktimi lë hapësirë që organet publike dhe private të mbledhin dhe grumbullojnë sasi të mëdha të të dhënave personale, që ato janë të panevojshme dhe në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rekomandojmë që në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktohen qartë kategoritë e të dhënave që do të përpunohen me atë rast.

Përpos mungesës së kornizës ligjore të qartë, që përcakton kategoritë e të dhënave që mund të përpunohen, njëkohësisht në shumicën e rasteve mungon dhe koha e ruajtjes, ku si pasojë kemi grumbullimin dhe mbajtjen e të dhënave personale me vite të tëra përkundër arritjes së qëllimit për të cilën fillimisht janë grumbulluar.

Rekomandojmë që në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktohet qartë koha e ruajtjes së të dhënave.

Mosratifikimi i *Konventës 108 për Mbrojtjen e Individit me Rastin e Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale*, nga ana e Kuvendit të Kosovës e pamundëson Agjencinë që të anëtarësohet në organizmat evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Po ashtu, në mungesë të ratifikimit të kësaj konvente, Kosova nuk mund të jetë pjesë e listës së shteteve që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale në kuadër të Bashkimit Evropian. Si rrjedhojë, transferimi i të dhënave personale në drejtim të Republikës së Kosovës hasë në vështirësi.

I rekomandojmë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, që si objektiv të vetin të kenë me prioritet procedimin dhe ratifikimin e Konventës 108 të vitit 1981.

7 Raporti Financiar

7.1 Përmbledhje të Zhvillimeve Kryesore për Buxhetin

Agjencia ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur në pajtim me ligjin. Buxheti i Agjencisë përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e mbikëqyrësit kryesor shtetëror, duke respektuar planifikimin buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

ASHMDHP, përvitin fiskal 2015, ka pasur buxhetin final të ndarë sipas Ligjit për Buxhet fillestar në vlerë prej €348,883.00, me rishikim buxhetor është larguar buxheti prej 1,446.00 euro (644.00 euro në paga dhe 802.00 euro në mallra dhe shërbime, pavarësisht që ne kishim krëkesë shtesë buxhetore), gjatë vitit kemi përfituar donacione dhe të hyra në vlerë prej 12,317.08 euro (buxhet i pranuar nga Banka 'Teb', Ambasada Norvegjeze dhe 'Vala').

ASHMDHP ka funksionuar me buxhetin final në vlerë prej €360,754.08, në këtë shpërndarje: paga dhe mëditje €211,539.00, mallra dhe shërbime €142,765.08 dhe shërbime komunale €6,450.00.

Në vitin 2015, ASHMDHP ka shpenzuar rreth 96,49% të buxhetit të përgjithshëm apo €348,096.96 ng akto kategori: paga dhe mëditje 98,49% apo €208,358.55, mallra dhe shërbime 97,02% apo €138,517, 98 dhe shërbime komunale 18,92% apo €1,220.43.

Buxheti në mallra dhe shërbime prej €142,765.08 është akumuluar nga totali i buxhetit në mallra dhe shërbime, shuma prej €130,448.00 nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe €12,317.08 donacione dhe të hyra, ku Agjencia ka përfituar donacione nga donatorët: 'Vala', Ambasada Norvegjeze, Banka 'TEB', Projekti IPA dhe OSBE-ja - përmes të cilave kemi organizuar Konferencën Ndërkombëtare 'Privatësia në Epokën Dixhitale' më 26, 27, 28 janar 2015 dhe aktivitet tjera gjatë vitit 2015. Këto mjete janë transferuar në kodet buxhetore të Agjencisë për vitin 2015, në mallra dhe shërbime dhe kanë arritur masën buxhetore të Agjencisë për vitin 2015.

Si shkak i buxhetit të pamjaftueshëm në vitin 2014 dhe 2015 dhe në mospërputhje me nevojat dhe kërkesat për përmbushjen e përgjegjësisë, Agjencia në fillim të vitit 2015 ka dalë me rreth 15,885.00 euro obligime të faturave të papaguara nga kontratat afatgjata si dhe nuk ka mundur të realizojë disa prej objektivave bazë të prolonguara në vitin 2016, për shkak të mungesës buxhetore, siç janë:

- 3) Fushata ndërgjegjëse për qytetarët, subjektet kontrolluese, si pasojë e së cilës nuk ka mundur të inicohet regjistrimi i të gjitha subjekteve kontrolluese.
- 4) Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore kur dihet që natyra e punës së Agjencisë dhe pamundësia e trajnimeve brenda vendit për zyrtarët mbrojtës të akredituar në institucionet publike dhe private;
- 5) Funksionalizimi i strukturës organizative të Agjencisë (shtimi i numrit të personelit);

7.2 Përmbledhje për të Hyrat dhe Kategoritë e Veçanta të Shpenzimeve

- a) **Tëhyrat** - Agjencia, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka themeluar dhe mbanë regjistër të sistemit të dosjeve.
- Brenda vitit 2015, nga 22 kontrollues kanë sjellur 84 njoftime për regjistrimin e sistemit të dosjeve nga kontrolluesit e sektorit privat. Në kuadër të të hyrave të regjistruara nga ASHMDHP të gjeneruara nga njoftimet për regjistrim nga subjektet kontrolluese, 'Neptun' SHPK ka bërë dy (2) pagesa; njëra për dosjet e aktivitetit të shitjeve në shumë prej €100, tjetra për dosjet e burimeve njerëzore në vlerë prej €20. Nga kontrolluesit publikë, gjatë vitit 2015, Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, në emër të dosjeve të kategorizuara si dosje të komisionit diciplinor, ka bërë pagesën prej €1 në sajë të procedurës së regjistrimit të filluar në fund të vitit 2014. Gjithësej gjatë vitit 2015 kemi pasur €121.00 nga të hyrat për regjistrimin e sistemit të dosjeve.
- b) **Pagatdhemëditjet** - në kategorinë paga dhe mëditje kemi pasur buxhetin endarë në vlerë prej €211,539.00 dhe në vitin 2015 kemi shpenzuar rreth 98,49% të buxhetit apo €208,358,55. ASHMDHP ka 23 zyrtarë të lejuar për punësim, prej tyre 5 funksionarë publikë të emëruar nga Kuvendi dhe 18 tetëmbëdhjetë shërbyes civilë. Nga janari deri në dhjetor, numri i të punësuarëve ka qenë 23 punonjës. Gjatë vitit kemi pasur dy zyrtarë me nga tre muaj në pushim pa pagesë. Fonde për paga (edhe pas rritjes së pagave) ka pasur të mjaftueshme për këtë numër të punëtorëve, por me këto pozita të pakta nuk mund të funksionalizohet struktura organizative me tridepartamente, e cila buron nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ligjet tjera për ngritjen kontrollit të brendshëm, realizimin e shpenzimeve dhe ngritjen e shkallëve për funksionalizimin e plotë të Agjencisë. Në kërkim të vazhdimësishtimin e numrit të zyrtarëve edhe për 9 pozita dhe rritjen e pagave bazuar në fushëveprimtarinë e veçantë të Agjencisë dhe punës shumëfish të vendimesh të sëqë bëjnë zyrtarë të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- c) **Mallra dhe Shërbime** - në kategorinë mallra dhe shërbime kemi pasur buxhetin e ndarë në vlerë prej €142,765.08 dhe në vitin 2015, kemi shpenzuar €138,517.98 apo 97.02 % të buxhetit. Buxheti prej €142,765.08 është akumuluar nga totali i buxhetit në mallra dhe shërbime, shuma prej €130,448.00 nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe €12,317.08 donacione dhe të hyra, vlenë të ceket se ne kemi shpenzuar vetëm €126,209.90 buxhetin tonë në mallra dhe shërbime dhe kemi kursyer €4,238.10 nga buxheti ynë dhe kemi shpenzuar donacionet në vlerë prej €12,317.08 të cilat i kemi pranuar nga donatorët. Në fillim të vitit 2015 kemi pasur obligime të papaguara prej vitit 2014 në vlerë prej €15,885.88 dhe nga kjo gjendje do të kishim shumë tejkalime po mos ti përfitonim donacionet. Gjatë vitit 2015 i kemi paguar obligimet e vitit 2014 dhe në janar të vitit 2016 kemi dalë me €2,625,06 obligimet e muajit dhjetor 2015. Kemi

zvogëluar shpenzimet në çdo aspekt dhe kemi arritur që mos të kemi obligime prej 16,000.00 që na ka përcjellë çdo vit nga viti 2011, kur edhe është themeluar Agjencia.

d) Shpenzime Komunale

në kategorinë shërbime komunale kemi pasur buxhetin e ndarë në vlerë €46,450.00 dhe në vitin 2015 kemi shpenzuar €1,220.43 apo 18,92% e buxhetit.

Gjatë kësaj kohe në nën-kategorikë kemi shpenzuar vetëm shpenzime të telefonisë fikse €1,220.43. Përveç telefonisë fikse, obligimet tjerë komunale, siuji, rryma, nxemja janë të mbuluar nga MAP.

e) Investimet Kapitale - Nuk kemi pasur buxhet dhe nuk kemi shpenzime në këtë kategori.

f) Subvencionet dhe Transferet - Nuk kemi pasur buxhet dhe nuk kemi shpenzime në këtë kategori.

7.3 Përmbledhje e Vërejtjeve Përfundimtare dhe Pikëpamjet për Zhvillimet e Ardhshme

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pasur buxhetin final të ndarë me donacione të pranuar, buxheti prej €360.754,08, përkundër kërkesës së Agjencisë për €548,500,00. Agjencia ka përfituar grantet në vlerë prej €12.196,08 nga donatorët: 'Vala', Ambasada Norvegjeze, Banka 'TEB', Projekti IPA dhe OSBE- përmes të cilave kemi organizuar Konferencën Ndërkombëtare 'Privatësia në Epokën Dixhitale' më 26, 27, 28 janar 2015, sepse me buxhetin tonë në mallra dhe shërbime në vlerë prej €130.448,00 nuk mund të organizohet konferencë e as të përmbillen obligimet ligjore të ASHMDHP-së.

Me këtë buxhet të ndarë dhe me tetëmbëdhjetë punonjës të lejuar, Agjencia nuk do të ketë mundësi të funksionalizohet e as të operacionalizojë sektorë të caktuar brenda saj, në përputhje me ligjin.

Për shkak të mungesës buxhetore nuk kemi mundur të realizojmë disa prej objektivave bazë të cilat i kemi prolonguar në vitin 2016, siç janë:

- Fushata ndërgjegjësuere për qytetarët, subjektet kontrolluese, si pasojë e së cilës nuk ka mundur të përfundohet regjistrimi i subjekteve kontrolluese.
- Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore kur dihet që natyra e punës së Agjencisë dhe pamundësia e trajnimeve brenda vendit për zyrtarët mbrojtës të akredituar në institucionet publike dhe private;
- Funksionalizimi i strukturës organizative të Agjencisë (shtimi i numrit të personelit);
- Perktimi i legjislacionit evropian që ndërlidhet me mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia gjatë vitit 2016 ka bërë kërkesë për vazhdimin e projektit IPA nga Komisioni Evropian, sepse pa mbështetjen financiare dhe të kapaciteteve njerëzore të Projektit IPA dhe me buxhetin minimal si dhe mungesën e kapaciteteve, nuk do të mund të realizojmë planin e punës 2016 - kur tani veç janë dorëzuar rekomandimet e para nga ekspertët të IPA-së dhe Komisionit Evropian rreth ndryshimeve ligjore dhe shtimin e autorizimeve për Agjencinë edhe për përgjegjësinë shtesë në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të këtij viti, fusha e mbrojtjes së të dhënave personale gjendet në fazën e hershme të zhvillimit, në të cilën autoriteti i mandatuar

(ASHMDHP) jep kontributin e tij në zbatimin e standardeve evropiane. RP thekson se ekziston nevoja për të përforcuar kapacitetet e saj, përfshirë shtimin e stafit të kualifikuar dhe burimeve financiare.

7.3.1 Objektivate Vazhdueshme 2014-2016

Mbikëqyrja e vazhdueshme e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave synohet të arrihet duke zhvilluar aktivitete në dy fusha:

- Edukimin e kontrollorëve;
- Ngritjen e vetëdijes së qytetarëve;
- Harmonizimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* të BE-së;
- Zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit përmes inspektimeve dhe kontrolleve;
- Trajtimin e ankesave;
- Ngritjen e kapaciteteve

Zhvillimi i hovshëm në menaxhimin e të dhënave personale në teknologji dhe pamundësia që të jemi në hap me kohën dhe realizimin e objektivave bazë që përmbushin fushëveprimtarinë e Agjencisë – vet mungesa buxhetore në kategorinë mallra dhe shërbime përcakton projektet të cilat nuk mund të realizojë vet Agjencia. Nevoja për organizimin e fushatave senzibilizuese të vazhdueshme edhe në fushat tjera përveç arsimit – si në shëndetësi, shërbime për qytetarë dhe segmente tjera - buxheti është element i rëndësishëm për funksionimin e Agjencisë dhe shtimin e personelit në departamentet që fushëveprimtaria e tyre buron nga Ligji funksional 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7.4 Tabelat 5– Detajet e Shpenzimeve. Sipas Kodeve Ekonomike

7.4.1 Tëhyrat

Kodi Ekonomik	Kategoria Ekonomike	Tëhyrat e planifikuara /parashikuar apërvitin 2015	Tëhyrat vetana ketëbarturanga viti 2015	Tëhyrat reale zuar në vitin 2015
1	2	3	4	5
5600	Ambasadës Norvegjeze në e destinuar për organizimin e konferencës Java e Privatësisë, janar 2015	€4,196.08		0.00
5600	TEB BANKA e destinuar për organizimin e konferencës Java e Privatësisë, janar 2015	€3,000.00		
5600	PTK SHA (Vala) e destinuar për organizimin e konferencës Java e Privatësisë, janar 2015	€5,000.00		
5600	Të hyra nga regjistrimi i sistemit të dosjeve			€121.00



7.4.2 Shpenzimet e Përgjithshme

Kodi Ekonomik	Kategoria Ekonomike	Buxhetidheshpenzimet 2014			Buxheti vjetormeligjine buxhetit(2015)	Buxhetimeris hikim2015	Buxhetipër fundimtar2015	Shpenzimetd eri më31dhjetor	Zotimetderi më31dhjetor	Buxhetii zotuar(në%)	Buxhet ii shpenz uar
		Buxheti (2014)	Shpenzimet (2014)	% e shpenzim it		(nësekapasur ndryshime)	Me donacione, te hyra vetanake	2015	2015		(në%)
1	2	3			4	5	6	7	8	9	10
11000	PagadheMëditje	184,000.00	183,567.36	99,76%	212,183.00	211,539.00	211,539.00	208,358.55	208,358.55	98,49%	98,49%
13000	MallradheShërbime	133,040.00	132,737.97	99,77%	131,250.00	130,448.00	142,765.08	138,517.98	141,536.44	99,13%	97,02%
13200	ShpenzimeKomunale	4,660.00	3,486.24	74,81%	6,450.00	6,450.00	6,450.00	1,220.43	1,220.43	18,92%	18,92%
21000	Subvencioned heTransfere										
30000	InvestimetKapitale	50,000.00	49,890.00	99,78%							
	Gjithësej	371,700.00	369,681.57	99,46%	348,883.00	348,437.00	360,754.08	348,096.96	351,115.42	97,32%	96,49%



7.4.3 MallradheShërbime

		Buxheti 2014			Buxheti 2015		
13000	MALLRADHESHËRBIME Emriikategorisëekonomike	Planifikimi2014	Shpenzimetnë(2014)	%e shpenzimit	Planifikimi2015	Shpenzimetnë(2015)	%e shpenzimit
	GjithsejMallradheShërbime	133,040.00	132,737.97	99,77 %	142,765.08	138,517.98	97,02 %
1310	SHPENZIMETEUDHËTIMIT(N ENTOTALI)	20,000.00	26,368.63	131,84 %	19,250.00	20,457.45¹	109,59 %
13130	Shpenzimeteudhëtimizyrtarbr ndavendit	-	-	-	-	-	-
13131	Meditjaeudhëtimizyrtarbr endavendit	-	-	-	-	1,780.20	+%
13132	Akomodimigjatëudhëtimizyrtarbr endavendit	-	-	-	-	1,966.50	+%
13133	Shpenzimettjeratë udhëtimizyrtarbr endavendit	-	-	-	-	-	-
13140	Shpenzimeteudhëtimizyrtarjasht vendit	5,000.00	5,052.43	101 %	5,000.00	4,624.51	92,49 %
13141	Meditjaeudhëtimizyrtarjasht vendit	10,000.00	11,096.01	110 %	7,500.00	6,774.53	90,32 %
13142	Akomodimigjatëudhëtimizyrtarjas htvendit	5,000.00	7,161.17	143,2 %	3,000.00	2,641.21	88,04%
13143	Shpenzimettjeratëudhëtimizyrtarjas htvendit		3,059.02	+%	3,750.00	3,310.90	88,29 %

¹Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2015 janë: €20,457.45 (në kuadër të nënkategorisë 'shpenzime të udhëtimit' janë edhe shpenzimet për bileta të udhëtimit jashtë vendit si shkak i mungesës së kontratës së volitshme. Njëkohësisht ju njoftojmë se buxheti aktual prej €19,250.00 për udhëtime nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat kur dihet obligimi ligjor bazuar në Ligjin 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 4 - ky ligj zbatohet edhe në zyrat diplomatike dhe konsullore, si dhe në të gjitha përfaqësitë e tjera zyrtare të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, sa i përket inspektimit dhe kontrollit).



1330	SHËRBIMETETELEKO MUNIKIMIT(NËNTOT ALI) ²	12,000.00	4,517.93	37,64 %	17,000,00 (12BK, 5 Don)	18,486.60	108,74 %
13310	Shpenzimetpërinternet	2,000.00	233.88	11,69 %	1,000.00	620.30	62,03 %
13320	Shpenzimetetelefonisëmobile	9,000.00	4,194.35	46,60 %	15,000.00	17,702.90	118,01 %
13330	Shpenzimetpostare	1,000.00	89.70	8,97 %	1,000.00	163.40	16,34 %
13340	Shpenzimetepërdorimittëkabllit	-	-	-			
1340	SHPENZIMETPËRSHËRBIME(NËNT OTALI) ³	30,000.00	29,810.41	99,36 %	34,500.00 (31,5BK, 3Don)	34,510.23	100,02%
13410	Shërbimetearsimitdhetrajnimit	12,000.00	2,770.00	23,08 %	12,000.00	3,617.75	30,14%
13420	Shërbimetepërfaqësimitdheavokaturës	-	-	-		-	
13430	Shërbimetëndryshmeshë ndet.	1,000.00	180.00	18 %		-	
13440	Shërbimetëndryshmeintelektualedh ekëshilldhënëse	2,000.00	12,545.00	627,25 %	3,500.00	12,063.45	344,67%
13450	Shërbimeshtypje-jomarketing	3,000.00	2,980.00	99,33 %	7,500.00	8,253.78	110,05 %
13460	ShërbimeKontraktueseTjera	10,000.00	10,985.41	109,8 %	10,000.00	10,575.25	105,75 %
13470	ShërbimeTeknike	2,000.00	350.00	17,5 %		-	
13480	ShpenzimetpërAnëtarësim	-	-	-	1,500.00	-	- %

²Shërbimet e telekomunikimit €18,486.60 (në kuadër të nënkategorisë 'shpenzime të telekomunikimit' janë shpenzuar vetëm 108,74 % dhe arsyeja e shpenzimit ka qenë si shkak i mosfaturimit me kohë në vitin 2014 nga ana e operatorit 'Vala' dhe problemeve teknike në faturim që i kishte ky operator. Në mungesë të rishikimit buxhetor dhe pas kërkesës sonë për rishikim, ne kemi mbuluar shpenzimet tjera në kuadër të organizimit të konferencave për 28.01.2014 (Dita Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe 30.06.2014 (shënimi i Përvjetorit të Agjencisë). Donacionet e pranuar na kanë ndihmuar për ti realizuar objektivat tona.

³Shpenzimet për shërbime €34,510.23 (në kuadër të nënkategorisë 'shpenzime për shërbime' janë shpenzuar vetëm 100,02 % dhe jemi në kuadër të planifikimit të kodit buxhetor por shpenzimet në nënkode kanë lëvizur si shkak i nevojës së vazhdueshme për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse ne siguri të dhënave personale, TI, shërbime këshilldhënëse juridike dhe mbështetëse. Donacionet e pranuar na kanë ndihmuar për ti realizuar objektivat tona.



1350	BLERJE MOBILJE DHE P AJISJEVE (MEPAKSE €1000) (NË TOTALI)	8,750.00	7,607.40	86,94 %	8,000.00	5,690.00	71,12 %
13501	Mobilje (mëpakse €1000)				6,000.00	5,690.00	94,83 %
13502	Telefona (mëpakse €1000)	1,750.00	1,680.00	96 %			
13503	Kompjuterë (mëpakse €1000)	4,000.00	3,830.00	95,75 %			
13504	Harduer për teknologji informati ve (mëpakse €1000)	3,000.00	2,097.40	69,91 %			
13505	Makina fotokopjuese (mëpakse €1000)						
13506	Pajisjes speciale mjeksore (mëpakse 1000 euro)						
13507	Pajisjet e shërbimit policor (mëpak se €1000)						
13508	Pajisjet e trafikut (mëpakse €1000)						
13509	Pajisjet tjera (mëpakse €1000)	2,000.00	2,595.00	129,75 %	2,000.00		- %
1360	BLERJE TJERA - MALLRADHESHËRBIME (NË TOTAL)	9,000.00	11,298.87	125,54 %	9,000.00	13,574.54 ⁴	150,82 %
13610	Furnizime për zyre	9,000.00	11,298.87	125,54 %	9,000.00	13,199.54	146,66 %
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (j odre kazymtare)	-	-	-		375.00	+ %
13630	Furnizime mjeksore	-	-	-			
13640	Furnizime pastrimi	-					
13650	Furnizime veshmbathje	-					
13660	Akomodimi	-	-	-	-		

⁴Blerje tjera €13,574.54 (në kuadër të nënkategorisë 'blerje tjera', nevoja për material për zyre dhe material të nevojshëm për organizimin e konferencave dhe fushatave senzibilizuese - ka tejkalluar mjetet e ndara buxhetore në këtë kategori. Në fund të vitit 2015 ka qenë nevojë për gatitje dhe objektet për punë nga ana e Agjencisë për hapësirën e pranuar nga MAP-i). andaj edhe kemi tejkalluar mjetet e ndara buxhetore në këtë kategori të cilat i kemi kursyer nga kategoritë tjera buxhetore si kategoria 1420 shpenzimet e marketingut - por në mungesë rishikimi nuk kemi mundur të përshtasim me gjendjen fillestare). Donacionet e pranuar na kanë ndihmuar për të realizuar objektivat tona.



1370	DERIVATETDHELËNDËT DJEGËSE (NËNTOTALI)	14,000.00	9,397.44	67,12 %	14,000.00	12,088.98	86,34 %
13710	Vaj						
13720	Naftëpërngrohjeqendrore		409.45	+			
13730	Vajpërngrohje						
13740	Mazut						
13750	Qymyr						
13760	Dru						
13770	Derivatepërgjenerator						
13780	Karburantpërvetura	14,000.00	8,987.99	67,12 %	14,000.00	12,088.98	86,34 %
1380	LLOGARITËEAVANSIT (NËNTOTAL)	-	-	-	-	-	-
13810	Avaspërparatëimta(p.cash)						
13820	Avanspërudhëtimezyrtare						
13821	Avans						
13830	Avanspërmallradheshërbime						
13850	Avans-përambasadat						
1390	SHËRBIMETFINANCIARE(NËNTOTAL)	-	-	-	-	-	-
13911	ProvizionBankar-BankaQendrore						
13912	ProvizionBankar-RaiffeisenBank						
13913	ProvizionBankar-ProcreditBanke						
13915	ProvizionBankar- BankaPrivateeBiznesit						
13916	ProvizionBankar-BankaEkonomike						
13917	ProvizionBankar- NLBBankaPrishtina						
13918	ProvizionpërTarifatëNdryshme						
13940	KPA-ProvizioniBankar						



1395	SHËRBIMETEREGJISTRIMI TDHESIGURIMEVE(NËNTOTALI)	5,000.00	1,523.80	30,47 %	5,000.00	4,561.59	91,23 %
13950	Regjistrimiiautomjeteve	3,500.00	540.00	15,42 %	1,400.00	1,285.20	91,8 %
13951	Sigurimiiautomjeteve	1,000.00	963.80	96,38 %	3,500,00	3,206.39	91,61 %
13952	Taksakomualeeregjistrimitt ëautomjeteve	500.00	20.00	4,00 %	100.00	70.00	70 %
13953	Sigurimiindërtesavedhetjera						
1400	MIRËMBAJTJA(NËNTOTALI)	12,790.00	12,015.58	93,94 %	11,500.00	11,995.75	104,3 %
14010	Mirëmbajtjadheriparimi iautomjete.	5,000.00	5,315.58	106,31 %	6.000,00	10,695.75	178,2 %
14020	Mirëmbajtjaendërtesave						
14021	Mirembajtjaendërtesavetë banimit						
14022	Mirembajtjaendërtesav eadministrativeafariste	-	-	-			
14023	Mirëmbajtjaeshkollave	-	-	-			
14024	Mirëmbajtjaeobjekteve shendetesore	-	-	-			
14030	Mirëmbajtjaeautorrugëve	-	-	-			
14031	Mirëmbajtjaeautorrugëve regjionale	-	-	-			
14032	Mirëmbajtjaeautorrugëve lokale	-	-	-			
14040	MirëmbajtjaeTeknologjis ëInformative	5,790.00	5,000.00	86,35 %	3,500.00	1,300.00	37,14 %
14050	Mirëmbajtjaemobilevedhe paisjeve	2,000.00	1,700.00	85,00%	2,000.00		-%



1410	QIRAJA(NËNTOTALI)		8,700.00	+ %			
14110	Qirajapërndërtesa	0	8,700.00	+%			
14120	Qirajapërtokë						
14130	Qirajapërpaisje	-	-	-			
14140	Qirajapërmakineri	-	-	-			
14150	Qirajapërpordorimetjër ahapësinore	-	-	-			
1420	SHPENZIMETEMARKETING UT(NËNTOTALI)	10,500.00	3,358.70	33,58 %	10,500.00		- %
14210	Reklamadhekonkurset	5,000.00	3,358.70	33,58 %	5,000.00		- %
14220	Botimetepublikimeve	4,000.00		0%	4,000.00		- %
14230	Shpenzimetpërinformimpublik	1,500.00		0%	1,500.00		- %
1430	SHPENZIMETEPËRFAQËSIM IT(NËNTOTALI)	11,000.00	15,544.12	141,3 %	14,015.08 (10,5 BK, 3,5 D)	17,152.84⁵	122,38 %
14310	Drekatzyrtare	11,000.00	15,544.12	141,3 %	14,015.08	17,152.84	122,38 %
1440	SHPENZIMEVENDIMETE GJYKATAVE(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-
14410	Shpenzime-vendimetegjykatave						
1700	SERVISIMIIBORXHI T(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-
17000	Pagesaeborxhitqeveritar						

⁵ Shpenzimet e përfaqësimit €17.152,84 (në kuadër të nënkategorisë shpenzimet e përfaqësimit kemi mbuluar shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet për organizimin e konferencave, shtatë (7) fushata senzibilizuese nëpër të gjitha regionet, andaj edhe kemi tejkaluar mjetet e ndara buxhetore në këtë kategori të cilat i kemi kursyer nga kategoritë tjera buxhetore si kategoria 1420 shpenzimet e marketingut – por në mungesë rishikimi nuk kemi mundur të përshtasim me gjendjen fillestare). Donacionet e pranuar na kanë ndihmuar për ti realizuar objektivat tona.



7.4.4 Shpenzimet Komunale

		Buxheti2014			Buxheti2015		
1320	ShpenzimeKomunale	Planifikimi2014	Shpenzimet(2014)	%e shpenzimit	Planifikimi2015	Shpenzimet(2015)	%e shpenzimit
	GjithsejShpenzimeKomunale	4,660.00	3,486.24	77,81 %	6,450.00	1,220.43	18,92 %
1320	SHPENZIMEKOMUNALE(NËNTOTALI)	4,660.00	3,486.24	77,81 %	6,450.00	1,220.43	18,92 %
13210	Rryma						
13220	Uji	1,000.00	1,001.84	100,18 %			
13230	Mbeturinat						
13240	Ngrohjaqendrore						
13250	Shpenzimettelefonike	3,660.00	2,484.40	67,88 %	6,450.00	1,220.43	18,92 %

7.4.5 Investimet Kapitale

		Buxheti 2014			Buxheti 2015			
3000	INVESTIMET KAPITALE	Planifikimi	Shpenzimet	% e shpenzimit	Planifikimi	Shpenzimet	Zotimet deri 31.12.2015	% e shpenzimit
Gjithsej InvestimetKapitale		50,000,00	49,890.00	99,78 %				
3110	NDËRTESAT(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
31110	Ndërtesatebanimit							
31120	Ndërtesatadministrativeafariste							
31121	Objektetarsimore							
31122	Objektetshëndetësore							
31123	Objektetkulturore							
31124	Objektetsportive							
3120	NDËRTIMIIRRUGËVE(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
31210	Ndërtimiiautorrugëve							
31220	Ndërtimiirrugëveverjonale							
31230	Ndërtimiirrugëvevelokale							
31240	Trotuarët							
31250	Kanalizimi							
31260	Ujësjetllësi							

3150	FURNIZIMI MERRYME, GJENERIMI (NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
31510	Furnizim merrymëgjenerim dhe transmision							
3160	PAJISJE (SIST. VLERAMBI €1000) (NËNTOTALI)							
31600	Pajisjet e Teknologjisë Informative (në vlerë mb i € 1000)				-	-	-	-
31610	Pajisjet e Teknologjisë Informative							
31620	Mobilje							
31630	Telefona							
31640	Kompjuter							
31650	Makina Fotokopjuese							
31660	Pajisje Speciale Mjekësore				-	-	-	-
31670	Pajisjet e Shërbimeve Policore				-	-	-	-
31680	Softuer				-	-	-	-
31690	Pajisje Tjera				-	-	-	-
3170	AUTOMJETET TRANSPORTI (NËNTOTALI)	50,000.00	49,890.00	99,78 %				
31700	Veturazrytare	50,000.00	49,890.00	99,78 %				
31701	Kamionë	-	-	-				
31702	Xhip dhe kombibusë	-	-	-				
31703	Veturat e ndihmës së shpejtë	-	-	-				
31704	Veturat e shërbimit policor	-	-	-				
31705	Motorë	-	-	-				
31706	Automjetet transportit tjera	-	-	-				



3180	MAKINERIA(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
31800	Makineria							
3190	KAPITALTJETËR(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
31900	Kapitaltjetër							
31910	Avanspërinvestime							
3210	TOKA(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
32100	Toka							
3220	PASURITËEPAPREKSHME(NËNTOTALI)	-	-	-	-	-	-	-
32200	Pasuriepaprekshme							
3310	TRANSE.KAPITALE- ENTITETE(NËNTOTALI)		-	-	-	-	-	-
33100	Trans.kap.-entitetetpublike							

7.4.6 Subvencione dhe Transfere

		Buxhet2014			Buxheti2015		
21000	Subvencione dhe Transfere	Planifikimi	Shpenzimetnë	%e shpenzimit	Planifikimi	Shpenzimet	%e shpenzimit
Gjithsej subvencionedhetransfere							
2100	SUBVENCIONET	-	-	-	-	-	
21110	SubvencionetpërEtnitetePublike						
21120	SubvencionetpërEtnitetePublike						
21200	SubvencionetpërEtniteteJopublike						
2200	TRANSFERET	-	-	-	-	-	
22100	Transferepërqeveritjera						
22110	UNOPS-projektiadministratësAgjensioniKosovariPronës						
22200	Pagesatpërperfituesindividual						
22210	Pensionetbazë						
22220	Pensionetpërpersonameaftësitekufizuar						
22230	Pensionetendihmëssociale						
22235	PensioneteTMK-es						
22240	Pensionet-KategoriaI						
22250	Pensionet-KategoriaII						
22260	PagesatpërInvalidëtluftes						
22270	Pagesatpërinvalidëtcivilë						
22280	Pagesatefamiljevetëtërënëveneluftë						
22300	Pagesa-vendimegjyqësore						



7.4.7 Personeli dhe Struktura e Pagave

Totali i shpenzimeve të pagave dhe medijave për vitin 2015 ka qenë 208,358.55 euro.

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet Buxhetit për Vitin 2015	Pozitat e plotësuara	Buxheti i aprovuar me Ligjin e Buxhetit për Paga dhe Meditje	Buxheti i shpenzuar për paga deri me 31 dhjetor 2015	Totali i pagesave shtesë	Numri i përgjithshëm i të punësuarve që pranojnë pagesa shtesë	a). Orari i punës (orari i plotë/gjysëm orari dhe b). Të specifikohet lloji i pagesës shtesë
1	2	3	4	5	6	7	8
Niveli i Bordit	5	5	90,961.00	90,961.00	0	0	Orari i plotë
Niveli i menaxhmentit të lartë	1	1	15,548.00	15,548.00	0	0	Orari i plotë
Niveli i menaxhmentit	5	5	38,685.00	36,165.00	1,260.00	1	Orari i plotë
Niveli profesional	10	10	57,475.00	51,294.55	1,260.00	1	Orari i plotë
Niveli mbështetës	2	2	8,870.00	8,870.00	0	0	Orari i plotë
Totali	23	23	211,539.00	202,838.55	2,520.00		Orari i plotë

202,838.55 + 2,520.00 = 208,358.55 euro (totali pagave 2015)



8 Raportimi rreth Adresimit të Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm

Menaxhmenti i ASHMDHP-së ka monitoruar në vazhdimësi adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin 2015 dhe ka bërë progres të theksuar në këtë drejtim. Për një periudhë të shkurtër kohore kemi arritur të adresojmë shumicën e rekomandimeve. Kjo tregon gatishmërinë dhe angazhimin e menaxhmentit për të përmirësuar kontrollet në vazhdimësi.

Raporti i auditimit për PVF-të e ASHMDHP-së, ka rezultuar më gjashtë rekomandime. Prej tyre pesë rekomandime janë adresuar plotësisht nga ana jonë, ndërsa një rekomandim është në proces të adresimit.

Procesi i filluar lidhur me adresimin e rekomandimit nr.4 është në proces pasi që ne kemi kërkuar në vazhdimësi rritjen e numrit të zyrtarëve edhe për nëntë (9) pozita sepse me tetëmbëdhjetë (18) zyrtarë të lejuar nuk mund të funksionalizohet struktura organizative me tri departamente, e cila buron nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ligjet tjera për ngritjen e kontrollit të brendshëm, realizimin e shpenzimeve dhe ngritjen e shkallëve hierarkike.

Kërkesë për shtimin e personelit e cila është bazë e nevojshme për funksionim të plotë të ASHMDHP-së, tani është edhe kërkesë nga Raporti i Progresit 2015.

Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.

Tabela:6- Rekomandimet e Auditorit

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1	Rekomandimi 1: Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurohet se komisionet e vlerësimit bëjnë vlerësimin e drejtë të ofertave duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.	Në mungesë të personelit për të caktuar në komisione, shpeshherë në komisione jemi të detyruar të caktojmë personelin mbështetës dhe joprofesional në lëmin përkatës. E kemi njoftuar personelin se duhet shikuar vërtetimin tatimor se a ka obligime tatimore të pashlyera dhe menaxheri i prokurimit ka ndërmarrë veprimet njoftuese për mospërseritje.	Janar-dhjetor 2015	Rekomandim i pëmbushur
2	Rekomandimi 2: Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurohet që të ketë proces të mjaftueshëm të menaxhimit të shpenzimeve. Agjencia mundet ose të vazhdojë të përdorë shërbimet e prokurimit të ndonjë subjekti tjetër publik në kuadër të një kontrate të re, ose të gjejë ndonjë formë tjetër brenda legjislacionit në fuqi.	MKSH ka lidhur marrëveshje të mirëkutimit me MPJ-në, me 31.12.2014 për ofrimin e shërbimeve administrative, prokurimit dhe auditimit të brendshëm dhe gjatë këtij viti kemi shmangur rrezikun e shfrytëzimit të kontratave të autoritetit tjetër pas skadimit të marrëveshjes.Njëkohësisht kemi trajnuar personelin lidhur me procedurat e prokurimit.	Janar-dhjetor 2015	Rekomandim i pëmbushur
3	Rekomandimi 3 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurohet për mbikëqyrje rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar me rregulla financiare	Agjencia ka buxhetin vjetor në mallra dhe shërbime prej 130.448,00 euro, përkundër kërkesës e cila ka qenë 248,500,00 euro. Në janar 2015 kemi dalur me obligime të papaguara nga viti 2014 në shumën prej 15.885,88 euro. Bazuar në planifikimin e ASHMDHP-së, ne jemi duke anuluar pjesën më të madhe të kërkesave, si dhe i kemi shtyrë disa prej objektivave bazë për vitin e ardhshëm buxhetor, por kemi vendime të cilat medeomos tërheqin implikime buxhetore.	Janar-dhjetor 2015	Rekomandim i pëmbushur



4	Rekomandimi 4 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurohet se për të gjithë të punësuarit të cilët konsiderohen si persona në marrëdhënie punë sipas rregullës financiare, pagesat të realizohen përmes listës së pagave.	Nekemikërkuarnë vazhdimësi rritjen e numrit të zyrtarëve edhe për nëntë (9) pozita sepse me tetëmbëdhjetë (18) zyrtarë të lejuar nuk mund të funksionalizohet struktura organizative me tri departamente, e cila buron nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ligjet tjerë për rritjen e kontrollit të brendshëm, realizimin e shpenzimeve dhe rritjen e shkallëve hierarkike.	Janar-dhjetor 2015	Në process e sipër
5	Rekomandimi 5 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të përcjellë veprimet e ndërmarra për ti eliminuar mospërputhjet e pozitive në mes listës së pagave dhe akt emërimeve deri në harmonizimin e plotë të tyre.	Agjencia i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për mospërputhjet e pozitive në mes listës së pagave dhe akt-emërimeve, siç është cekur edhe në rekomandimin nr.5. Gjithashtu duhet të cekim se ne në vazhdimësi do të përcjellim në MAP listën me emra të akt emërimeve për harmonizim të plotë të tyre.	Janar-dhjetor 2015	Rekomandim i pëmbushur
6	Rekomandimi 6 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurohet që regjistrat e pasurisë janë përditësuar me informata të sakta dhe të plota para përgatitjes së PVF-së. Më tutje, ky regjistër duhet të përditësohet rregullisht me informatat e reja.	Tani jemi në fazën e certifikimit të zyrtarit alternativ për pasuri sepse deri tani kemi pasur një zyrtar financiar të angazhuar në pesë funksione por rekomandimi lidhet me pamundësinë e regjistrimit të pasurisë kapitale pasi që pranimi ka ndodhur në ditën e fundit të vitit fiskal 2014 dhe nuk kemi pasur mundësi teknike për rregullim dhe përditësim të pasurisë së plotë në vitin e kaluar. Këtë vit kemi zyrtarët kompetentë të angazhuar nga MPJ, kemi përditësuar pasurinë kapitale me të dhëna të sakta.	Janar-dhjetor 2015	Rekomandim i pëmbushur